

VËLLIMI XXIX /PRILL-QERSHOR/ 2025

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS 2025

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

Nr.1173, Datë 09.04.2025	5
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJES AMERICAN HOSPITAL SHA DHE INTERNATIONAL HOSPITAL SHA NË TREGUN E SHËRBIMIT SPITALOR”	
Nr.1174, Datë 09.04.2025	7
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË WHITE ROADS HOTEL SHPK NGA Z. ALEKSANDËR FRANGAJ”	
Nr.1175, Datë 24.04.2025	11
“PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJEVE TË LIDHURA NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE KT&G CORPORATION”	
Nr.1176, Datë 24.04.2025	13
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK NGA SHOQËRIA BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”	
Nr.1177, Datë 24.04.2025	18
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SPAR ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA VIVA FRESH SHPK”	
Nr.1178, Datë 14.05.2025	22
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TË SHOQËRISË GREENLINK (LUXEMBOURG) S.Á.R.L. NGA SHOQËRIA SUSTAINLINK SARL”	
Nr.1179, Datë 14.05.2025	27
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË EKONOMIKE TË RRJETIT FARMACEUTIK NËN EMRIN TREGTAR “FARMA NET ALBANIA” NGA SHOQËRIA DITË E NATË SHPK”	
Nr.1180, Datë 14.05.2025	34
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË MED LAB SHPK NGA Z. KLODIAN ALLAJBEU”	
Nr.1181, Datë 05.06.2025	40

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK NGA SHOQËRIA UNION BANK SHA”	
Nr.1182, Datë 05.06.2025	42
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË KANARIJA, D.O.O. NGA SHOQËRIA ORVAS D.O.O.”	
Nr.1183, Datë 05.06.2025	46
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA INTER STOCK Albania SHPK, NGA SHOQËRITË AGNA SHA DHE INTER STOCK SHPK”	
Nr.1184, Datë 05.06.2025	50
“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA DHE INTER STOCK SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDË AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, TË SHOQËRISË INTER STOCK Albania SHPK”.	
Nr.1185, Datë 05.06.2025	53
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ECO RICIKLIM SHPK NGA SHOQËRIA ANAMARK SHPK”	
Nr.1186, Datë 26.06.2025	57
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË MD GREEN ENERGY SHPK NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”	
Nr.1187, Datë 26.06.2025	61
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË O-SP ALBANIA SHA NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”	
Nr.1188, Datë 26.06.2025	66
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TURE D.O.O. NGA SHOQËRIA ORVAS D.O.O.”	
Nr.1189, Datë 26.06.2025	67
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FASHION GROUP	

ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA ALBI HOLDING SHPK”

Nr.1190, Datë 26.06.2025	71
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT SHA”	
Nr.1191, Datë 26.06.2025	78
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SHA”	
Nr.1192, Datë 26.06.2025	85
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SHA”	
Nr.1193, Datë 26.06.2025	92
“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE BANKËS SË SHQIPËRISË PËR TREGUN E SHËRBIMEVE BANKARE NË BANKOMATE”	

VENDIM

Nr. 1173, Datë 09. 04. 2025

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJES
AMERICAN HOSPITAL SHA DHE INTERNATIONAL HOSPITAL SHA NË TREGUN
E SHËRBIMIT SPITALOR”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09. 04. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjes International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Në kuadër të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”, nëpërmjet të cilës i është kërkuar Autoritetit të Konkurrencës “Të ndërmarrë një procedurë monitorimi apo hetimi në tregun e shërbimit spitalor privat me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg”, Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 28, pika “a” të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka nisur procedurën e monitorimit të ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, duke analizuar kushtet e tregut, për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.
2. Gjatë procedurës së monitorimit Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të identifikuar institucioneve jo-publike të kujdesit shëndetësor sipas bashkive përkatëse, nga ku ka rezultuar sipas të ardhura nga aktiviteti i tyre në tregun e shërbimit spitalor privat, për periudhën Janar - Dhjetor 2023: American Hospital SHA zë rreth XX% të tregut sipas të ardhurave të pa tatuara totale, e ndjekur nga ndërmarrja International Hospital SHA me XX% të tregut, ndërmarrja Sombrero SHPK me XX%, ndërmarrja Salus Tirana SHA me XX%, German Hospital International SHPK me XX% të

tregut etj. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve zënë një përqindje shumë të vogël të tregut bazuar në të ardhurat e pa tatuara të realizuar për vitin 2023.

3. Ndërmarrjet American Hospital SHA dhe International Hospital SHA (shoqëri e bashkuar me përthithje nga American Hospital SHA) në kuptim të nenit 8 të Ligjit nr. 9121/2003 kanë pozitë dominuese bazuar në të ardhurat e pa tatuara të realizuara nga aktiviteti i tyre në tregun e shërbimit spitalor për periudhën 2022-2023.
4. Në vijim Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar spitaleve private duke kërkuar informacion mbi disa shërbime të cilat ofrohen vetëm pranë spitaleve private, duke kërkuar dhe tarifat përkatëse për secilën si dhe metodologjinë e llogaritjes së kostos për këto shërbime.
5. Ekskluziviteti i ndërmarrjeve American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në shërbime të caktuara si trombektomia mekanike (heqja e mpiksjes së gjakut në tru), PET-scan/PET-CT dhe transplantit i veshkave mund të luajë një rol në vlerësimin e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 nëse këto shërbime janë thelbësore dhe konkurrentët e tjerë nuk mund t'i ofrojnë ato.
6. Si përfundim sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor mund të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes American Hospital SHA dhe International Hospital SHA në tregun e shërbimit spitalor.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2022 deri në 31 dhjetor 2024.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1174, Datë 09. 04. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË WHITE ROADS HOTEL SHPK NGA Z. ALEKSANDËR FRANGAJ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09. 04. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK nga Z. Aleksandër Frangaj.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimëve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK nga Z. Aleksandër Frangaj,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK nga Z. Aleksandër Frangaj.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Shitblerje Kuote” të nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Aleksandër Frangaj shtetas shqiptar, zotërues i kuotave në shoqëri të tjera, që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pala Shitëse: GJIKURIA SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Ndërtim, montim dhe rikonstruksion i objekteve dhe veprave të çfarëdollojshme, industriale, turistike, civile. Asfaltim rrugësh, punime bonifikimi. Prodhim i materialeve të ndërtimit, si dhe transport i tyre. Grumbullim, transportim, seleksionim të mbetjeve urbane dhe riciklim, përpunim, presim të mbetjeve të riciklueshme, kompostim të mbetjeve organike etj.

Shoqëria Target: WHITE ROADS HOTEL SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi dhe operimi i strukturave hoteliere dhe/ ose objekteve turistike sezonale, administrimi i tij/tyre dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit në këtë zonë, përfshirë edhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur. Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari tregtare të tjera, që lidhen me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të marrë me qira pasuri të luajtshme, të paluajtshme, ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume të themeluara apo në themelim e sipër. Krijimi i faqeve web, platformave elektronike në internet dhe aplikacioneve me synim zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë edhe nëpërmjet pajisjeve elektronike të komunikimit në distancë etj.

Aktualisht WHITE ROADS HOTEL SHPK aktualisht zotërohet nga shoqëria GJIKURIA SHPK.

Referuar Formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, WHITE ROADS HOTEL SHPK nuk kontrollon asnjë ndërmarrje aktive në tregjet e prekura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

II. Transaksioni

Më datë [...], shoqëria GJIKURIA SHPK (në cilësinë e shitësit) dhe Z. Aleksandër Frangaj (në cilësinë e blerësit) kanë nënshkruar “Marrëveshje Shitblerje Kuote”.

Referuar kësaj marrëveshje, shitësi do të shesë të gjithë kuotën, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë target WHITE ROADS HOTEL SHPK tek blerësi, në përputhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje.

Pas përmbushjes së Kushteve Paraprake dhe pagesës së Këstit të Parë, palët do të nënshkruajnë Aktin e Transferimit të Kuotës, i cili do të shërbejë si provë e përmbushjes së Kushteve Paraprake, kryerjen e pagesës së Këstit të Parë nga Blerësi dhe rrjedhimisht kalimin e pronësisë së kuotës tek Blerësi. Pas nënshkrimit të këtij Akti nga palët dhe pagesës së Këstit të Parë nga blerësi, shitësi duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të detyrueshme sipas Ligjit të Aplikueshëm për të siguruar

regjistrimin e transferimit të pronësisë së kuotës së tij tek Blerësi, së bashku me dokumentet e nevojshme për këtë regjistrim tek Qendra Kombëtare e Biznesit.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target do të zotërohet plotësisht nga blerësi.

Për sa më sipër dhe referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

WHITE ROADS HOTEL SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi dhe operimi i strukturave hoteliere dhe/ ose objekteve turistike sezonale, administrimi i tij/tyre dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit në këtë zonë, përfshirë edhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur, etj.

WHITE ROADS HOTEL SHPK nuk kontrollon asnjë ndërmarrje tjetër.

WHITE ROADS HOTEL SHPK aktualisht është duke zhvilluar [...] “WHITE ROADS HOTEL”, të cilit i është njohur statusi [...]. Sipas këtij Vendimi dhe [...].

WHITE ROADS HOTEL i është dhënë statusi i veçantë [...] Në vijim të këtij statusi, WHITE ROADS HOTEL ka nënshkruar një [...]. Në bazë të kësaj marrëveshje, WHITE ROADS HOTEL përfiton ndër të tjera, [...] dhe lehtësi të tjera që i akordohen atij, në bazë të statusit [...] sipas parashikimeve të posaçme të legjislacionit në fuqi.

[....]

Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përkufizimi “treg përkatës” do të përfshijë dy komponentë:

- I. tregu përkatës i produktit, dhe
- II. tregu përkatës gjeografik.

Për vlerësimin e tregut përkatës merret parasysh zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe zëvendësueshmëria nga na e ofertës.

Nga pikëpamja e zëvendësueshmërisë, shërbimet e akomodimit të ofruara nga strukturat e ndryshme akomoduese kanë shkallë të ndryshme zëvendësueshmërie ndërmjet njëra-tjetrës.

Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, mund të themi se strukturat e ndryshme akomoduese kanë shkallë të ulët zëvendësueshmërie ndërmjet njëra-tjetrës, por brenda të njëjtës kategori ka zëvendësueshmëri të afërt midis tyre, për sa i përket shërbimeve të ofruara, cilësisë dhe çmimit. Pra hotelet që ofrojnë shërbime me standard të ngjashëm janë zëvendësues të afërt të njëri- tjetrit.

Në anën e ofertës strukturat e ndryshme akomoduese nuk janë të zëvendësueshme midis njëra tjetrës, duke u nisur nga lloji i ndërtesës, sipërfaqja që kanë në dispozicion, etj.

Referuar tregut në të cilin ushtron aktivitetin shoqëria target, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimit të akomodimit nga hotelet me 4 dhe 5 yje dhe resortet.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet zona gjeografike e Bashkive Vlorë dhe Himarë.

Referuar deklaratës së palëve, me hyrjen e tij në këtë treg, WHITE ROADS HOTEL do të kontribuojë në rritjen e standardeve të industrisë duke ofruar produkte dhe shërbime të një cilësie të lartë, gjë që u krijon konsumatorëve më shumë mundësi zgjedhjeje [....]. Ky angazhim për cilësi dhe shërbim të shkëlqyer garantohej nga [...]. [...].

Duke marrë parasysh se tregu i ofrimit të shërbimit të akomodimit në Shqipëri është një treg dinamik dhe në zhvillim, shoqëria target është në fazën e [...], si dhe nuk ka mbivendosje të aktiviteteve të palëve, transaksioni i propozuar nuk kufizon konkurrencën në tregun përkatës.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk pritet të sjellë ndikim në konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë WHITE ROADS HOTEL SHPK nga Z. Aleksandër Frangaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1175, Datë 24. 04. 2025

**“ PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË
MARRËVESHJEVE TË LIDHURA NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS
PRODUCTS S.A DHE KT&G CORPORATION”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 04. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i kërkesës për shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve të lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”; Rregullorja “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara”; Rregullorja “Për kategoritë e Marrëveshjeve të Specializimit”; Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur dhe Marrëveshjet

Konfidenciale

II Analiza e Konkurrencës

Konfidenciale

PËR KËTO ARSYE:

- Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të shtyjë afatin e përjashtimit nga ndalimi të “Marrëveshjes Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, “Marrëveshjes për Licencën e Markës Tregtare” dhe “Marrëveshjes së Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën”, të lidhura ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation, për një periudhë 2(dy) vjeçare nga marrja e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1176, Datë 24. 04. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK NGA SHOQËRIA BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 04. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit, i realizuar nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës janë njoftuar ndryshime në statutin e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (Balfin SHPK) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: (i) investimi

në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softuare etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, etj.

Balfin operon në një numër të madh industrish si në Sektorin Bankar, në Zhvillimin e Pasurive të Paluajtshme, në Administrim Qendrash Tregtare, në Industrinë Retail, Logjistike Transport, etj. Shoqëria zotëron 60 % të kapitalit të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

Pala 2: z. Artan Hoxha, shtetas shqiptar, aktualisht zotërues në masën 40% të kapitalit të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

Shoqëria target: TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Ofrimi i studimeve të nivelit universitar dhe pasuniversitar në fushat e ekonomisë, administrimit të biznesit dhe jurisprudencës. Studime dhe kërkime shkencore të ndryshme në fushat e ekonomisë, administrimit dhe jurisprudencës dhe të krijojë kapitalin e saj intelektual në të mire të zhvillimit të vendit dhe rritjes së mireqenies së shoqërisë shqiptare. Ofrimi i trajnimeve dhe kurseve të ndryshme afatshkurtra dhe afatgjata dhe të kryejë botime dhe publikime të ndryshme në fushat e ekonomisë, administrimit të biznesit dhe jurisprudencës. Të bashkëpunojë me institucione të ndryshme private, publike dhe OJF shqiptare dhe të huaja, për realizimin e praktikave mësimore, studimeve dhe kërkimeve të ndryshme, fushatave të ndryshme sensibilizuese. Të mbledhë donacione dhe fonde financiare nga burime të ndryshme në shërbim të veprimtarisë së saj.

Shoqëria target nuk ka Filiale në pronësi të saj apo investime të kuotave të kapitalit në shoqëri të tjera.

II. Transaksioni

Në datë [_____] , nëpërmjet dokumentit “Akt Kalim Kuote”, shoqëria TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK ndryshon strukturën e ortakërisë, ku Z. Artan Hoxha bëhet zotërues në masën 40% të kapitalit të shoqërisë, ndërkohë që shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, zotëron 60% të kuotave të kapitalit.

Në po të njëjtën datë, [_____] , dy ortakët e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, z. Artan Hoxha dhe shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group, kanë miratuar Statutin e shoqërisë, ku në nenin 11.2 të Statutit theksohet se: Asambleja e Përgjithshme merr vendime me unanimitet - votën pro të ortakëve pjesëmarrës që përfaqësojnë 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Në rast mos-dakordësie midis Ortakëve, vota e z. Artan Hoxha, zotërues i X% të kapitalit të Shoqërisë, *ka përparësi*.

Ortakët, në mënyrë të shprehur, pranojnë dhe deklarojnë se Z. Artan Hoxha i rezervohet një e

drejtë votimi me përparësi mbi Ortakët e tjerë, duke marrë në konsideratë përvojën shumëvjeçare në fushën e arsimit dhe duke i dhënë mundësinë të mbajë kontrollin mbi procesin e vendimmarrjes.

Në datë [____], ortakët e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK kanë miratuar ndryshime në pikën 11.2 të Statutit të shoqërisë target, ku përcaktohet se: Asambleja e Përgjithshme vendos për ndryshimet e Statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë me votën pro të ortakëve pjesëmarrës që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të merren me shumicë votash – vota pro të ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 50% e kapitalit të Shoqërisë.

Referuar ndryshimit të mësipër, transaksioni i propozuar përbënte përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, i cili ka për pasojë përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, nga shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK dhe z. Artan Hoxha.

Gjatë procedurës së kontrollit të përqendrimit, shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, me shkresën nr. 33/2 prot., i AK-së, datë 10.02.2025 “Argumentime në lidhje me kontrollin e vetëm dhe ndikimin në vendimmarrjen strategjike”, kanë paraqitur në Autoritetin e Konkurrencës pretendimet në lidhje me formën e kontrollit të shoqërisë, duke interpretuar se shoqëri Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK ka aftësinë dhe kontrollin e vetëm për të marrë vendimet strategjike kyçe për shoqërinë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK të trajtuara dhe cilësuar në pikat më lart, pa pasur nevojë për miratimin e aksionerëve të tjerë. Këto vendime kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në orientimin dhe zhvillimin afatgjatë të kompanisë dhe që lidhen me zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, politikat e çmimeve, shtrirjen në tregje të reja, strategjitë e rritjes dhe zhvillimit, diversifikimin e portofolit, ndryshimin e modeleve të biznesit dhe investimet kapitale.

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 07.03.2025, mori në shqyrtim rastin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK dhe mbështetur në nenin 39 të ligjit dhe nenin 24 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, me shkresën nr. 309 datë 11.03.2025 “Ftesë për tu dëgjuar”, ftoi dy ortakët e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, për të diskutuar mbi pretendimet për formën e kontrollit të shoqërisë target.

Në vijim të procedurës, me shkresën nr. 33/8 prot., i AK datë 11.04.2025 “Dërgim dokumentacioni shtesë në kuadër të njoftimit të transaksionit mbi shoqërinë Tirana Business University SHPK”, shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK depozitoi pranë Autoritetit të Konkurrencës Statutin e rindryshuar të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

Në datë [____], ortakët e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK dhe z. Artan Hoxha, miratuan ndryshime në statutin e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK dhe konkretisht në nenin 11 “Kompetencat e Asamblesë dhe Kuorumi”, pika 11.2, në të cilin është parashikuar se: “Asambleja e Përgjithshme merr vendime me unanimitet - votën pro të ortakëve pjesëmarrës që përfaqësojnë 100% (një qind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Në rast mos-dakortësie midis ortakëve, vota e shoqërisë Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, zotërues i 60% të kapitalit të Shoqërisë, ka përparësi. Pra, në mënyrë të shprehur, ortakët pranojnë dhe deklarojnë se shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, i rezervohet një e drejtë votimi me përparësi mbi Ortaket e tjerë.”

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, Seksioni 1.2 “Mënyra e kontrollit” është parashikuar se: *“Kontrolli përkufizohet sipas nenit 10 të ligjit si një mënyrë për të ushtruar influencën vendimmarrëse mbi një ndërmarrje. Mundësia për të ushtruar influencën vendimmarrëse mbi një ndërmarrje mund të ekzistojë mbi bazën e të drejtave, kuotave ose mjeteve të tjera, veçmas ose te kombinuara dhe duke patur parasysh faktet.*

Me ndryshimet e fundit në Statutin e shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, vota e shoqërisë Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, ka përparësi mbi Ortakët e tjerë, duke i dhënë të drejtën e vendimmarrjes dhe për pasojë përfundimin e kontrollit të vetëm mbi shoqërinë target, TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, u konstatua se ndryshimet e fundit në statut kanë patur për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërinë target, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës dhe ka për pasojë përfundimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK, nga shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të do të konsiderohet sektori i arsimit të lartë jopublik dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe z. Artan Hoxha.

Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një grup i diversifikuar investimesh, i angazhuar kryesisht në shitjen me pakicë të produkteve ushqimore dhe industriale, pasuritë e paluajtshme, veprimtarinë minerare dhe shërbimet bankare.

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK ofron shërbime edukative dhe akademike të nivelit universitar dhe pasuniversitar në fushat e ekonomisë, administrimit të biznesit dhe jurisprudencës, studime dhe kërkime shkencore, etj.

Nëpërmjet këtij ndryshimi të kontrollit, shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK synon të rrisë efikasitetin dhe performancën e TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK në sektorin e arsimit të lartë, duke përfshirë optimizimin e aktiviteteve të saj akademike, strategjike dhe zhvillimin e mundësive të reja, me qëllim që të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor.

Duke marrë parasysh pjesën e vogël të tregut të TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK në sektorin e arsimit të lartë jopublik, transaksioni i njoftuar nuk pritet të sjellë shqetësime për konkurrencën në treg.

Për sa më sipër, përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, pasi nuk do të krijohet mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë TIRANA BUSINESS UNIVERSITY SHPK nga shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1177, Datë 24. 04. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SPAR ALBANIA SHPK
NGA SHOQËRIA VIVA FRESH SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 04. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë shitblerje kuote”, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: Viva Fresh SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës. Viva Fresh SHPK, është pjesë e rrjetit të supermarketeve që operon në Kosovë dhe rajon, e cila zotërohet XX% nga ortaku i vetëm z [...].

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj si aktivitet kryesor; Tregtinë me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani. Aktivitet sekondar: Tregtinë me pakicë të frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara. Aktivitete të tjera: Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara.

Viva Fresh SHPK, ka deklaruar se zotëron njëkohësisht dhe shoqëritë:

I. Sipas legjislacionit të Shqipërisë

1. “[...]” SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, dhe me objekt aktiviteti: Import, Eksport, shitje e mallrave me shumicë dhe/ose pakicë, e ushqimit, pijet, fruta dhe perime, duhani, tekstili, këpucëve dhe artikuj prej lëkure, pajisjeve elektronike shtëpiake, tregti me pakicë të mallrave të ndryshëm të reja, lulet dhe bimët, përpunimi dhe konservimi i mishit, restorantet, artikuj shërbyes të pijeve të ushqimit, si çdo aktivitet tjetër tregtar i ligjshëm dhe i aplikueshëm në Republikën e Shqipërisë, etj.

II. Sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut

1.[....], shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë Veriore, me objekt aktiviteti kryesor: Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht të ushqimeve, pijeve dhe duhanit.

2. [.....], shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë Veriore, me objekt aktiviteti kryesor: Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht të ushqimeve, pijeve dhe duhanit.

Pala shitëse: Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: (i) investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj,etj.

Aksionar i kësaj shoqërie është Z. Samir Mane me 100% të kuotave.

Shoqëria Target: Spar Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Kuota e shoqërisë target përbëhet nga (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të SPAR Albania SHPK.

Spar Albania SHPK zotëron një rrjet supermarketesh në Shqipëri, që operon në markën ndërkombëtare Spar, e cila zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i saj Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë: ngritjen, hapjen dhe administrimin të marketeve, supermarketeve dhe hipermarketeve “Spar” në Shqipëri dhe jashtë saj; import-eksport dhe /ose kultivim, prodhim, përpunim i produkteve ushqimore; import-eksport dhe /ose prodhimi i produkteve jo-ushqimore; shitja me shumicë dhe/ose pakicë e produkteve ushqimore – të përpunuara ose të papërpunuara dhe jo-ushqimore; stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore të përpunuara ose të papërpunuara dhe jo-ushqimore; transport i mallrave dhe udhëtareve brenda dhe jashtë vendit, shërbime të ndryshme konsulence. Gjithashtu shoqëria mund të kryej çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industrial, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Transaksioni

Më datë [...] është lidhur “ Kontratë shitblerje kuote” ndërmjet shoqërisë Viva Fresh SHPK (blerësi), shoqërisë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK (shitësi) dhe shoqërisë Spar Albania SHPK (target), si palë të kësaj kontrate.

Referuar objektit të kësaj Marrëveshje, shitësi do të shesë 100% kuotën e shoqërisë target Spar Albania SHPK (së bashku me të gjitha të drejtat dhe interesat që u lidhën me të në datën e finalizimit të transaksionit) tek blerësi dhe blerësi do të blejë 100% kuotën e shoqërisë target nga shitësi, të pastër dhe të lirë nga çdo barrë, kundrejt pagesës së çmimit.

Detyrimi i blerësit për të blerë kuotën e shoqërisë target dhe detyrimi i shitësit për ta shitur kuotën sipas kontratës, nënshtrohet dhe kushtëzohet nga përmbushja e kushteve të përcaktuara në nenin 6 dhe 7 të kontratës. Pas datës së nënshkrimit dhe para datës së finalizimit, çdo palë do të njoftojë me shkrim për përmbushjen e këtyre kushteve. *Kjo kontratë do të konsiderohet e pavlefshme dhe pa fuqi juridike nëse nuk janë përmbushur të gjitha kushtet ose nëse prej kushteve nuk është hequr dorë me shkrim nga pala e cila përfiton prej tyre sipas afateve të përcaktuara në Marrëveshje.*

Palët do të finalizojnë transaksionin jo më vonë se data e 120 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate ose në cilido afat tjetër të përcaktuar në dakordësi të dokumentuar me shkrim ndërmjet palëve. Secila palë duhet të ketë nënshkruar Deklaratën për Përmbushjen e Kushteve dhe secila palë duhet të ketë nënshkruar Deklaratën për Axhustimin e Çmimit të Shitjes.

Marrëveshja përcakton dhe detyrimin për të marrë miratimet e nevojshme lidhur me transferimin e pronësisë së kuotës nga; (i) [...] dhe (ii) [...].

Nëse për çdo arsye, finalizimi i transaksionit nuk mund të ndodhë në datën e finalizimit të transaksionit, palët do takohen 5 ditë pune më vonë dhe do përpiqen sërish të procedojnë me finalizimin e transaksionit. Nëse finalizimi nuk ndodh edhe në këtë rast, palët do të bëjnë përpjekje për arritjen e një marrëveshje me shkrim për finalizimin e transaksionit dhe në rast se palët nuk

lidhin dot një marrëveshje të tillë brenda datës [...], kontrata do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur pa cënuar të drejtat, detyrimet e palëve në lidhje me këtë zgjidhje.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Përqendrimi i njoftuar pritet të mos krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” Komisioni i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e njoftimit mbi finalizimin përfundimtar të transaksionit të realizuar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e finalizimit përfundimtar të transaksionit.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, njoftimin nga palët pjesëmarrëse në transaksion mbi finalizimin përfundimtar të këtij transaksioni, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1178, Datë 14. 05. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TË SHOQËRISË GREENLINK (LUXEMBOURG) S.Á.R.L. NGA SHOQËRIA SUSTAINLINK SARL”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 05. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l. nga shoqëria SustainLink SARL.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l. nga shoqëria SustainLink SARL,

VËREN SE :

1. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l. nga shoqëria SustainLink SARL.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shit-blerje të kuotave dhe kredive të dhëna të aksionarëve të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l.”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: SustainLink SARL¹ është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: të përvetësojë interesa, si në Luksemburg ashtu dhe jashtë tij, në çdo shoqëri apo ndërmarrje të çfarëdo forme,

¹ fillimisht i quajtur me emrin Marty Holding 5 S.á.r.l.

dhe të menaxhojë këto interesa. Shoqëria në veçanti mund të blejë me abonim, blerje dhe këmbim ose në ndonjë mënyrë tjetër, tituj, aksione dhe tituj të tjerë të kapitalit, obligacione, llogari të arkëtueshme, certifikata depozitash dhe instrumenta të tjera borxhi, dhe në përgjithësi, tituj dhe instrumente financiar të emetuara nga subjekte publike ose private, etj.

Kapitali i shoqërisë blerëse zotërohet XX% nga ortakut Baltic Cable AB, një shoqëri e regjistruar në regjistrin tregtar të Suedisë, e angazhuar në transmetimin e energjisë dhe XX% nga ortakut Equitix Murphy Bidco Limited, një shoqëri e regjistruar në Angli dhe Uells.

- **Baltic Cable AB**, një shoqëri në pronësi të Grupit Statkraft dhe pronari i vetëm i interkoneksionit nënë 600 MW HVDC Baltic Cable që lidh tregjet gjermane dhe suedeze të energjisë elektrike (DE/LU-SE4). Ky aset lehtëson transmetimin dhe tregtimin e energjisë elektrike midis dy rajoneve. Baltic Cable AB është i certifikuar si operator i sistemit të transmetimit (OST) sipas modelit të ndarjes së operatorit të pavarur të transmetimit (OPT), i cili vendos kërkesa strikte për ndarjen midis aktiviteteve të shoqërisë Baltic Cable AB dhe Statkraft Group. Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisë prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

- **Equitix Murphy Bidco Limited** është një shoqëri që zotërohet indirekt nga [_____], e cila kontrollohet nga Equitix Investment Management Limited, një shoqëri e regjistruar në Angli dhe Uells.

Equitix është një investitor, zhvillues dhe menaxhues afatgjatë i fondeve të infrastrukturës bazë dhe aseteve të efikasitetit të energjisë. Equitix Group menaxhon disa fonde infrastrukturore, fonde të shumta bashkë-investimesh, të cilat janë të dedikuara për projekte më të mëdha infrastrukturore dhe një numër llogarish të ndara të menaxhuara që ofrojnë zgjidhje të personalizuar.

Grupi Equitix nuk ka asnjë filial dhe nuk gjeneron asnjë të ardhur në Shqipëri.

Pala shitëse:

Shitësit institucional

1. Partners Group Greenlink Access 1, L.P. është një shoqëri komandite, e themeluar sipas legjislacionit të Skocisë, me objekt aktiviteti: realizimi në Skoci dhe në vende të tjera mbi biznesin

e kryerjes së investimeve në kapital privat, borxh privat, pasuri të paluajtshme ose një klas tjetër aktivesh, siç mund ta gjykojë ortaku i përgjithshëm i partneritetit.

2. Partners Group Greenlink Access 2 L.P. është një shoqëri komandite, e themeluar sipas legjislacionit të Skocisë , me objekt aktiviteti: realizimi në Skoci dhe në vende të tjera mbi biznesin e kryerjes së investimeve në kapital privat, borxh privat, pasuri të paluajtshme ose një klas tjetër aktivesh, siç mund ta gjykojë ortaku i përgjithshëm i partneritetit.

3. Partners Group Greenlink Access 3 L.P. është një shoqëri komandite, e themeluar sipas legjislacionit të Skocisë , me objekt aktiviteti: realizimi në Skoci dhe në vende të tjera lidhur me biznesin e kryerjes së investimeve në kapital privat, borxh privat, pasuri të paluajtshme ose një klas tjetër aktivesh, siç mund ta gjykojë ortaku i përgjithshëm i partneritetit.

Shitësit institucionalë kontrollohen indirekt nga Partners Group Holding AG, një shoqëri zviceriane me kapital privat e listuar në Bursën SIX Swiss Exchange. Partners Group është një shoqëri globale investimesh në tregjet private, e cila kontrollon një numër shoqërish portofoli që janë aktive në një shumëllojshmëri sektorësh në juridiksione të ndryshme.

Shitësit menaxhues

1. Oweca B.V., është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me objekt aktiviteti: zotërime financiare.

2. Padraig McManus dhe John Shine shtetas me vendbanim në Irlandë.

Target: Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut dhe objekti i aktivitetit të shoqërisë është: të veprojë si një shoqëri investimi dhe të koordinojë veprimtarinë e të gjitha subjekteve korporative në të cilat shoqëria ka një interes të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë dhe të blejë (qoftë me abonim fillestar, tender, blerje, shkëmbim ose ndryshe), të gjitha ose çdo titull, aksione, detyrime, obligacione dhe tituj të tjerë të emetuara ose të garantuara nga çdo person dhe instrumente të tjera, si dhe të mbajë instrumente të tilla si investime dhe ti shesë, këmbejë dhe disponojë ato; të kryejë çdo veprimtari tregtare ose biznes të çdo lloji.....; Të investojë dhe menaxhojë paratë dhe fondet e shoqërisë në çdo mënyrë që Drejtori i vetëm ose Bordi i Drejtorëve (sipas rastit) e konsideron të përshtatshme; Të marrë hua , të mbledhë ose të garantojë pagesën e parave në çdo mënyrë që Bordi i Drejtorëve e konsideron të përshtatshme, duke përfshirë emetimin (brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni i Luksemburgut) të obligacioneve dhe titujve të tjerë.

Target është pronar i një kabloje ndërlidhëse të energjisë elektrike nënujore dhe nëntokësore (me stacionet e ndërlidhura të konvertimit) që lidh rrjetet ekzistuese të energjisë elektrike në Irlandë dhe Britaninë e Madhe), me një kapacitet nominal prej 504 MW.

Greenlink (Luxembourg) S.á.r.l., si një shoqëri holding, zotëron filialet: (i) Greenlink Interconnector Group Holdings Limited; (ii) Greenlink Interconnector Holdings Limited; (iii)

Greenlink Interconnector Financing Limited; (iv) Greenlink Interconnector Trading Limited; (v) Greenlink Interconnector Limited dhe (vi) Greenlink Developments Limite.

[_____].

2. Transaksioni

Më datë 14 mars 2025, pala blerëse SustainLink SARL dhe pala shitëse e përbërë nga Shitësit Institucional dhe Shitësit Menaxhues kanë nënshkruar “Marrëveshje për shit-blerje të kuotave dhe kredive të dhëna të aksionarëve të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.à.r.l.”.

Shitësit zotërojnë 100% të kapitalit aksionar të emetuar të shoqërisë dhe të kredive të aksionarëve. Në varësi dhe në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshje shitësit kanë rënë dakord të shesin, dhe blerësi kanë rënë dakord të blejë, të gjitha aksionet e emetuara nga shoqëria dhe huatë e aksionarëve.

Në përfundim të transaksionit, palët deklarojnë se shoqëritë Baltic Cable AB dhe Equitix Murphy Bidco Limited, nëpërmjet blerësit SustainLink SARL do të kenë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë target dhe mbi të gjithë kapitalin e emetuar.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.à.r.l. nga shoqëria SustainLink SARL, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për ofrimin e kapaciteteve të ndërlidhjes për transmetimin e energjisë elektrike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Blerësi, SustainLink SARL është një shoqëri e sapokrijuar, e themeluar për qëllime të transaksionit, dhe e kontrolluar bashkërisht nga Baltic Cable AB dhe Equitix Murphy Bidco Limited.

Baltic Cable AB është pronari i vetëm i interkoneksionit nënujor 600 MV HVDC që lidh tregjet gjermane dhe suedeze të energjisë elektrike dhe ka qenë pronari i vetëm që nga fillimi i operacioneve në 1994. Ai është i certifikuar si operator i sistemit të transmetimit (OST).

Baltic Cable AB është pjesë e Grupit Statkraft, i cili është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Equitix Murphy Bidco Limited është pjesë e grupit Equitix, i cili është një investitor, zhvillues dhe menaxher afatgjatë i fondeve të infrastrukturës bazë dhe aseteve të efecencës dhe energjisë. Ai menaxhon disa fonde infrastrukture, fonde të shumta bashkë-investimesh, të cilat janë të

dedikuara për projekte më të mëdha infrastrukturore dhe një numër llogarish të ndara të menaxhuara që ofrojnë zgjidhje të personalizuar.

Grupi Equitix nuk ka filial dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Shoqëria target, Greenlink (Luxembourg) S.à.r.l është një shoqëri holding, e cila ka në pronësi një kablo ndërlidhëse të energjisë elektrike nënujore dhe nëntokësore (me stacionet e ndërlidhura të konvertimit) që lidh rrjetet ekzistuese të energjisë elektrike në Irlandë dhe Britaninë e Madhe me një kapacitet nominal prej 504 MW.

[_____]

Asnjë nga palët në transaksion nuk është e angazhuar në transmetimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe nuk realizojnë të ardhura në tregun përkatës.

Për sa më sipër, përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese pasi nuk do të krijohet mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Greenlink (Luxembourg) S.à.r.l. nga shoqëria SustainLink SARL.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1179, Datë 14. 05. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË EKONOMIKE TË RRJETIT FARMACEUTIK NËN EMRIN TREGTAR “FARMA NET ALBANIA” NGA SHOQËRIA DITË E NATË SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 05. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK.

Referuar tre (3) dokumenteve “Marrëveshje për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DITË E NATË SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medikal device me pakicë etj.

DITË E NATË SHPK zotëron X % të kuotave në shoqërinë DITË E NATË Online SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medikal device online me pakicë etj.

DITË E NATË SHPK zotërohet X % nga shoqëria METRO FARMACI SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtim civile të të gjitha llojeve; aktivitete në fushën e ndërtimeve civile, zbatime dhe projekte, prodhime materiale inerte, gurë qeramikë etj; import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve farmaceutikë.

Kjo e fundit zotërohet X % nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK, e cila zotëron kuota në shoqëritë: DELTA PHARMA – AL SHPK, AVICENA SHPK, FARMED ANTIBIOTICS SHPK, BIO DERMA SHPK dhe SMART TECH SOLUTION SHPK.

Pala Shitëse:

- **Farma Net Albania SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-eksport, ruajtje, shpërndarje, shitje me shumicë e pakicë e artikujve farmaceutikë dhe parafarmaceutikë, barnave narkotike dhe psikotrope, produkteve dhe shtesave ushqimore me origjinë shtazore, produkteve bimore, produkte kozmetike, bimëve medicinale, pajisjesh dhe materiale mjekësore, dentare, laboratorike, reagenteve dhe kiteve etj. Farma Net Albania SHPK zotërohet X % nga ortakut Sokol Topçiu.
- **SensiBlu SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti farmaci, ku kryhet furnizimi, ruajtja, përgatitja, ambalazhimi, paketimi, kontrolli, dhënia e barit dhe informacionit për përdorimin e tij, si dhe shërbime të tjera të kujdesit shëndetësor. SensiBlu SHPK zotërohet X % nga shoqëria Farma Net Albania SHPK.
- **eFarma.AL SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim me pakicë i barnave, medikamenteve e produkteve farmaceutike të të gjitha llojeve, të artikujve kozmetikë dhe suplementeve ushqimore; laborator mjekësor, laborator klinik biokimik, mikrobiologjik dhe gjenetik, analiza klinike, biologji molekulare, gjenetike, biokimike, imunologjik, hormonale. Shitja me shumicë dhe pakicë e produkteve kozmetike, suplementeve ushqimore, vitaminave, importi dhe shitja me shumicë e pakicë e pajisjeve mjekësore etj. Shoqëria eFarma.AL SHPK zotërohet X % nga ortakut Venetia Topçiu.

Farma Net Albania SHPK, eFarma.AL SHPK dhe SensiBlu SHPK ushtrojnë aktivitetin e tyre nën emrin tregtar “*Farma Net Albania*”.

Target: Veprimtaria Ekonomike e njësive farmaceutike nën emrin tregtar “Farma Net Albania” që do të përfshijë të gjitha Pajisjet dhe Aktivitetet e luajtshme si Asetet, Inventarët; Të drejtat e Pronësisë Intelektuale; Klientët; Kontratat e Transferuara; Punëmarrësit dhe Detyrimet. Në kushtet në të cilat transferohen, këto Aktive, Punëmarrës dhe Detyrimet janë në gjendje të vazhdojnë veçmas një veprimtari ekonomike të pavarur.

II. Transaksioni

Më datë [____], shoqëria “DITË E NATË” SHPK dhe shoqëritë eFarma.AL SHPK, Farma Net Albania SHPK dhe SensiBlu SHPK kanë lidhur individualisht “Marrëveshje për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike”, për transferimin e rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania”, në pronësi të DITË E NATË SHPK.

Shoqëria Farma Net Albania SHPK dhe shoqëria DITË E NATË SHPK kanë lidhur “Marrëveshje për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike”, për [____] farmaci, të cilat do të kalojnë në pronësi të DITË E NATË SHPK.

Shoqëria eFarma.AL SHPK dhe shoqëria DITË E NATË SHPK kanë lidhur “Marrëveshje për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike”, për dy [____] farmaci, të cilat do të kalojnë në pronësi të DITË E NATË SHPK.

Shoqëria SensiBlu SHPK dhe shoqëria “DITË E NATË” SHPK kanë lidhur “Marrëveshje për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike”, për [____] farmaci, e cila do të kalojë në pronësi të DITË E NATË SHPK.

Sipas këtyre marrëveshjeve, eFarma.AL, Farma Net Albania SHPK dhe SensiBlu SHPK do të transferojnë Veprimtarinë Ekonomike të rrjetit të farmacive “Farma Net Albania” tek DITË E NATË SHPK, sipas kushteve të këtyre Marrëveshjeve, në Mbyllje. Veprimtaria Ekonomike përfshin Pajisjet dhe Aktivitetet e Luajtshme si Asetet dhe Inventarët; Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale; Klientët; Kontratat e transferuara; Punëmarrësit; të cilat janë në gjendje të vazhdojnë veçmas një veprimtari ekonomike të pavarur.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i kontrollit” parashikohet se: Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose aseteve të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre aseteve. Përfitim i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, *vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.*

Siç u përmend edhe më sipër dhe referuar marrëveshjeve të nënshkruara, Veprimtaria Ekonomike përfshin Pajisjet dhe Aktivitetet e Luajtshme si Asetet dhe Inventarët; Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale; Klientët; Kontratat e transferuara; Punëmarrësit; **të cilat janë në gjendje të**

vazhdojnë veçmas një veprimtari të pavarur ekonomike të tyre me kushte të ngjashme si para transferimit.

Nga vlerësimi i marrëveshjeve të mësipërme evidentohet transferimi i [_____] njësive farmaceutike, të cilat përbëjnë njësi biznesi me përfaqësim në treg, që krijojnë xhiro vjetore dhe në përfundim të transaksionit, këto njësi farmaceutike do të zotërohen plotësisht nga DITË E NATË SHPK.

Për sa më sipër dhe referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit i prekur nga transaksioni do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë të barnave dhe produkteve farmaceutike. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet qarku Tiranë.

III.1 Struktura e tregut të shitjes me pakicë të produkteve farmaceutike

Shoqëria “DITË E NATË” SHPK operon në shitjen me pakicë nëpërmjet një rrjeti farmaceutik, i cili përbëhet aktualisht nga 67 farmaci të shpërndara në Tiranë dhe qytetet kryesore.

Palët shitëse do të transferojnë Veprimtarinë Ekonomike të njësive farmaceutike nën emrin tregtar “Farma Net Albania”, e cila do të përfshijë të gjitha Pajisjet dhe Aktivitetet e luajtshme si Asetet, Inventarët; Të drejtat e Pronësisë Intellektuale; Klientët; Kontratat e Transferuara; Punëmarrësit dhe Detyrimet. Në kushtet në të cilat transferohen, këto Aktive, Punëmarrës dhe Detyrimet, janë në gjendje të vazhdojnë veçmas një veprimtari ekonomike të pavarur.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, përqendrimet horizontale ndodhin në rastet kur ndërmarrjet pjesëmarrëse janë konkurrentë aktualë ose potencialë në të njëjtin treg përkatës.

Si shoqëria target, ashtu edhe pala blerëse janë të pajisura me licencë për tregtim me pakicë të barnave, për këto arsye, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, pasi pala blerëse dhe shoqëria target ushtrojnë aktivitetet në tregun e shitjes me pakicë të produkteve farmaceutikë si farmaci.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, pjesët e tregut dhe indekset e përqendrimit janë treguesit e parë të nevojshëm të fuqisë së tregut dhe rëndësisë së konkurrencës si të palëve pjesëmarrëse në përqendrim ashtu edhe të konkurrentëve të tyre. Pjesët e mëdha të tregut, 50 % e më tepër, në vetvete përbëjnë një evidencë të ekzistencës së një pozicioni dominant në treg.

Niveli absolut i indeksit HHI na jep një tregues fillestar të presionit të konkurrencës në treg pas përqendrimit. Ndryshimi HHI (Delta HHI) është një e dhënë e nevojshme për të parë ndryshimet e drejtpërdrejta në treg të shkaktuara nga përqendrimi. Përqendrimet horizontale nuk shfaqin shqetësime për konkurrencën nëse indeksi HHI është nën 1000 ose HHI është ndërmjet 1000 dhe 2000 dhe një delta HHI është nën 250.

Përqendrimet horizontale sjellin kufizime të konkurrencës në treg edhe në rastet kur klientët e palëve pjesëmarrëse në përqendrim mund të kenë vështirësi për të kaluar tek ofrues të tjerë sepse ekzistojnë pak ofrues alternativë dhe këmbimi shoqërohet me kosto të ndjeshme.

Nga përpunimi i të dhënave të depozituara nga palët, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe nga analiza e strukturës së tregut, u konstatua se:

- Tregu i shitjes me pakicë të barnave dhe produkteve farmaceutike është një treg jo i përqendruar, me tregues të ulët të indeksit të përqendrimit HHI.
- Sipas treguesve të strukturës së tregut u konstatua se pjesët e tregut të shitjes me pakicë të produkteve farmaceutike të shoqërisë DITË E NATË SHPK, pas përqendrimit, do të jenë X % dhe delta HHI është X.
- Asnjë prej ndërmarrjeve nuk ka pjesë të mëdha tregu duke mos evidentuar një pozicion dominues në treg.
- Për shkak të numrit të madh të ndërmarrjeve që operojnë në të, produktet farmaceutike janë lehtësisht të zëvendësueshme nga ana e ofertës.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni i blerjes së Veprimtarisë Ekonomike të njërive farmaceutike nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK, nuk pritet të sjellë kufizime të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

III.2 Tregjet të tjera të prekura nga transaksioni

Nga vlerësimi i transaksionit të njoftuar është konstatuar se përqendrimi nuk shkakton vetëm efekte horizontale. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim nuk janë vetëm konkurrentë aktualë ose potencialë të njëri-tjetrit por kanë një marrëdhënie vertikale në më shumë se një treg përkatës. Për këto arsye, janë vlerësuar jo vetëm efektet horizontale por edhe ato vertikale të ndikuara nga transaksioni.

Nga vlerësimi i shoqërive të grupit, që kontrollojnë shoqërinë DITË E NATË SHPK, u konstatua se kjo e fundit kontrollohet indirekt nga shoqëria DELTA PHARMA – AL, një nga ndërmarrjet kryesore në tregun e shitjes me shumicë të produkteve farmaceutike.

Për këto arsye, evidentohet një integrim vertikal midis shoqërive DELTA PHARMA – AL SHPK dhe DITË E NATË SHPK.

Në udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, është përcaktuar se përqendrimet jo horizontale nuk shfaqin shqetësime për konkurrencën në treg, kur

pjesët e tregut të hyrësve të rinj pas përqendrimit në secilin nga tregjet në fjalë, është nën 25% dhe HHI pas përqendrimit është nën 1800.

Nga përpunimi i të dhënave të administruara si dhe nga analiza e strukturës së tregut, u konstatua se:

- Shoqëria DELTA PHARMA – AL SHPK zotëron X % në tregun e shitjes me shumicë të produkteve farmaceutike, në termat e të ardhurave vjetore 2024, ndërkohë që pjesa e tregut e DITË E NATË SHPK, pas përqendrimit është X % në tregun e shitjes me pakicë të produkteve farmaceutike.
- Në të dyja nivelet e tregtimit, tregjet nuk janë të përqendruara dhe indeksi i përqendrimit HHI është më i vogël se 1800.
- Referuar të dhënave mbi barnat ekskluzive, evidentohet se shoqëria DELTA PHARMA – AL SHPK ka realizuar shitje drejt një numri shumë të madh farmacish në të gjithë vendin, dhe shitjet drejt shoqërisë DITË E NATË SHPK, përbëjnë vetëm X % të shitjeve të realizuara nga DELTA PHARMA – AL SHPK, duke mos ngritur shqetësime për një integrim të fortë, e cila mund të çonte në ngurtësim të tregjeve dhe përjashtim të konkurrentëve aktual, të paktën në këtë tipologji produkti.
- Mbështetur në çmimin e shitjes së barnave ekskluzive drejt depove primare, depove sekondare dhe rrjetit të farmacive, nuk u evidentuan elemente të një sjellje antikonkurruese që mund të çonte në përjashtimin e konkurrentëve nga tregu nëpërmjet praktikës së “ngjeshjes së marxhit” (margine squeeze).

Nga analizat e kryera, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se transaksioni i njoftuar nuk do të sjellë shqetësime për konkurrencën as në integrimin vertikal, për shkak të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në tregjet e prekura nga transaksioni.

Me përfitim të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të njësive farmaceutike nën emrin tregtar “Farma Net Albania”, shoqëria DELTA PHARMA – AL SHPK, nëpërmjet shoqërisë DITË E NATË SHPK, zgjeron rrjetin e shitjes me pakicë të produkteve farmaceutike.

Pala blerëse është shprehur se transaksioni do të sjellë optimizimin e kostove të menaxhimit, duke menaxhuar më mirë burimet e personelit për një numër më të madh farmacish. Kjo pritet të sjellë rritjen e cilësisë së shërbimit; akses më të lartë në produktet e kërkuara, mundësinë e bashkëpunimit me farmaci të të njëjtit rrjet për të garantuar ruajtjen e cilësisë së produkteve të ofruara dhe kohën e shkurtër të përfimit të shërbimit

Për sa më sipër, u evidentua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Veprimtarisë Ekonomike të rrjetit farmaceutik nën emrin tregtar “Farma Net Albania” nga shoqëria DITË E NATË SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1180, Datë 14. 05. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË MED LAB SHPK NGA Z. KLODIAN ALLAJBEU”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 05. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga Z. Klodian Allajbeu.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga Z. Klodian Allajbeu”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga z. Klodian Allajbeu.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Z. Klodian Allajbeu shtetas shqiptar, i cili zotëron kuota respektivisht në shoqëritë: ANAMARK SHPK, EKMA ALBANIA SHPK, WESTERN BALKANS UNIVERSITY SHPK, FUTURE CEMENT SHPK, Con Energy Albania SHPK, ENERGY PROJECT SHPK dhe MEDICAL RECYCLING SHPK.

Shoqëritë e mësipërme kanë aktivitete në: shitje, blerje, dhënie/marrje me qira të pronave të paluajtshme, prodhim, realizim, impiante prodhimi energjie elektrike, trajtimi, riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve spitalore, hapja dhe menaxhimi i qendrave të përpunimit të mbetjeve spitalore, shërbimi spitalor, arsimit i lartë, etj.

Pala Shitëse: Znj. Rezalda Shehi, shtetase shqiptare, e cila para transaksionit zotëronte 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë target Med Lab SHPK.

Shoqëria Target: Med Lab SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje - blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësorë; import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore, etj.; investime, shërbime e projekte në fushën e mjekësisë e laboratorëve mjekësorë; ndërmarrja e nismave, veprimeve, aktiviteteve e pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme koncesionare, privatizimi apo tenderimi, etj.

Shoqëria Med Lab SHPK zotëron X % të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar.

II. Transaksioni

Ndërmjet Z. Klodian Allajbeu (blerësi), Znj. Rezalda Shehi (shitësi) dhe Z. Klodian Shehi (bashkëshorti pëlqim dhënës) është lidhur “Kontratë për shitjen e kuotës”, e cila u nënshkrua më datë [_____].

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi do t’ia shesë kuotën e zotëruar prej tij, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë target Med Lab SHPK, blerësit, i cili do të blejë atë sipas kushteve, afateve dhe modaliteteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj kontrate blerësi bëhet pronar i kuotës së zotëruar nga shitësi, pavarësisht momentit se kur kjo kontratë regjistrohet dhe publikohet pranë institucioneve përgjegjëse (si për shembull: *Qendra Kombëtare e Biznesit*, etj).

Në përfundim të transaksionit të njoftuar, shoqëria target Med Lab SHPK do të zotërohet nga blerësi Z. Klodian Allajbeu.

Për sa më sipër dhe referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Për vlerësimin e efekteve që transaksioni i njoftuar do të sjellë në treg, analiza e konkurrencës u realizua mbi tregun e prekur nga transaksioni. Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i tregtimit të

pajisjeve mjekësore dhe laboratorike dhe tregu përkatës gjeografik, territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike

Tregu i tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike funksionon në zbatim të ligjit nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar dhe shitja e tyre kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet.

Referuar dokumentacionit të depozituar, Z. Klodian Allajbeu zotëron kuota në shoqëri që kanë aktivitet si: shitje, blerje, dhënie/marrje me qira të pronave të paluajtshme; prodhim, realizim, impiante prodhimi energjie elektrike; shërbime spitalore; trajtimi, riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve spitalore; hapja dhe menaxhimi i qendrave të përpunimit të mbetjeve spitalore, riciklimi i mbetjeve spitalore, etj. Nëpërmjet këtij transaksioni, pala blerëse synon zgjerimin e aktivitetit dhe në tregun e shitjes së pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Shoqëria target, Med Lab SHPK është një shoqëri që ushtron aktivitetin në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike, por nuk ka ushtruar aktivitet dhe nuk ka realizuar shitje të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike gjatë viteve 2023 - 2024.

Oferta në treg sigurohet nga importi dhe nga përpunimi i të dhënave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, u konstatua se shoqëritë e kontrolluara indirekt nga z. Klodian Allajbeu (AMERICAN HOSPITAL SHA, International Hospital SHA dhe PHARMA ONE SHPK) kanë realizuar së bashku rreth X % të importeve të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Shoqëria target, Med Lab SHPK nuk ka realizuar importe dhe as shitje të produktit të tregut përkatës gjatë viteve 2023-2024, ndërkohë që shoqëritë e kontrolluara indirekt nga z. Allajbeu zotërojnë së bashku një pjesë shumë të vogël të importeve të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.

Nga përgjigjet e administruara nga AMERICAN HOSPITAL SHA, International Hospital SHA dhe nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, rezulton se importet e pajisjeve mjekësore dhe laboratorike janë realizuar për nevoja të vetë spitaleve, ndërkohë që nuk rezulton që shoqëria PHARMA ONE SHPK të ketë kryer shitje të këtyre produkteve tek dy spitalet e integruara.

Për sa më sipër, përftimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë Med Lab SHPK nga z. Allajbeu nuk do të ndikojë në strukturën e tregut dhe nuk do të shfaqë shenja të kufizimit të konkurrencës nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës.

Tregje të prekura nga transaksioni

Nga të dhënat e administruara, u evidentua se shoqëritë e kontrolluara indirekt nga z. Allajbeu ushtrojnë aktivitet në tregun e shërbimit spitalor. Gjithashtu, shoqëria target, Med Lab SHPK, pavarësisht mos kryerjes së aktivitetit ekonomik, zotëron kontroll të përbashkët mbi shoqërinë

PHARMA ONE SHPK së bashku me shoqërinë EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK, shoqëri të cilat ushtrojnë aktivitet në tregun e tregtimit të produkteve farmaceutike.

Për shkak të natyrës së aktivitetit, shërbimi spitalor dhe tregtimi i produkteve farmaceutike konsiderohen si tregje të lidhura për shkak të marrëdhënies tregtare, klient-furnitor.

Referuar udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, transaksioni i njoftuar ka efekte në tregje të lidhura, pasi shoqëria target, Med Lab SHPK është një shoqëri që ushtron aktivitetin në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike si dhe në tregun e shitjes së produkteve farmaceutike, ndërsa pala blerëse, z. Klodian Allajbeu zotëron kuota në shoqëri që kanë aktivitet në tregje të ndryshme nga tregu përkatës i produktit.

Kombinimi i produkteve në tregjet e lidhura, mund t’i japë shoqërive të kontrolluara nga blerësi mundësinë dhe ta nxitë që të transmetojë një pozicion tregu të fuqishëm nga një treg në një tjetër me anë të praktikave kushtëzuese ose praktikave të tjera përjashtuese.

Për të vlerësuar këto efekte, janë vlerësuar tregjet e lidhura, strukturat dhe sjellja e shoqërive të prekura nga transaksioni.

a) Tregu i shërbimi spitalor

Spektori i shëndetësisë funksion në zbatim të Ligjit nr. 10107, Datë 30.3.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, bazuar në parimet e kujdesit shëndetësor.

Mbështetur mbi të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi të ardhurat e realizuara nga shërbimi spitalor për vitin 2023², vihet re se rreth X % e të ardhurave në shërbimin spitalor realizohet nga spitalet publike, ndërsa pjesa tjetër prej X % nga ato private, ku AMERICAN HOSPITAL SHA realizon rreth X % të të ardhurave të shërbimit spitalor dhe International Hospital SHA X % të të ardhurave.

b) Tregu i tregtimit të produkteve farmaceutike

Tregu i shitjes së barnave funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

Mbështetur mbi të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbi subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregun e shitjes së produkteve farmaceutike, u konstatua një numër i madh ndërmarrjesh të cilat operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të produkteve farmaceutike gjatë viteve 2023 - 2024.

Referuar të ardhurave vjetore të deklaruara pranë DPT gjatë vitit 2024, nuk rezulton të këtë ndonjë ndërmarrje me pozitë dominuese. Pjesën më të madhe të tregtimit me shumicë të produkteve

² Burimi: AK, shkresat nr. 600/1 prot., datë 30.10.2023 “Kërkesë për informacion” dhe nr. 600/2 prot., datë 04.12.2023 “Rikujtesë mbi kërkesën për informacion nr. 600/1 prot., datë 30.10.2023” drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të monitorimit të spitaleve private.

farmaceutike për vitin 2024 e realizon shoqëria CFO PHARMA me X %, e ndjekur nga REJSI FARMA dhe DELTA PHARMA - AL me XXX, TRIMED dhe ALFARMAKOS me X %. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve kanë një pjesë më të vogël se X % në shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike, ku PHARMA ONE SHPK realizon X % të shitjeve me shumicë të produkteve farmaceutike, ndërsa EVITA SHPK X % për vitin 2024, me një trend të lehtë në rënie krahasuar me vitin 2023.

c) Efektet e përqendrimit

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, kombinimi i produkteve në tregjet e lidhura, mund t’i japë njësisë së përqendruar mundësinë dhe ta nxitë që të transmetojë një pozicion tregu të fuqishëm nga një treg në një tjetër me anë të praktikave kushtëzuese ose praktikave të tjera përjashtuese (të lidhura).

Njësia e përqendruar mund të jetë e aftë të përjashtojë konkurrentët, nëse ajo do të zotëronte një shkallë të ndjeshme të fuqisë së tregut, por jo domosdoshmërisht të jetë me pozitë dominuese në një nga tregjet në fjalë.

Duke qenë se në mënyrë indirekt, z. Allajbeu ka kontroll të përbashkët tek shoqëria PHARMA ONE SHPK dhe njëkohësisht kontrollon indirekt edhe dy spitalet jopublike, me qëllim vlerësimin e efekteve të transaksionit në tregjet e lidhura, është analizuar marrëdhënia tregtare midis shoqërisë PHARMA ONE SHPK dhe AMERICAN HOSPITAL SHA dhe International Hospital SHA.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëritë PHARMA ONE SHPK dhe AMERICAN HOSPITAL SHA e International Hospital SHA u konstatua se:

- nuk rezulton të ketë një lidhje të fortë midis aktiviteteve të shoqërisë PHARMA ONE SHPK dhe dy spitaleve AMERICAN HOSPITAL SHA dhe International Hospital SHA. Shoqëria PHARMA ONE SHPK ka të orientuar aktivitetin e saj tregtar drejt rrjetit të farmaceutikave, shitjes me pakicë të produkteve farmaceutike, të cilat përbëjnë X % të shitjeve totale të produkteve farmaceutike. Shitjet e produkteve farmaceutike drejt dy spitaleve private zënë vetëm X % të shitjeve totale.
- nuk rezulton të ketë një lidhje të fortë midis dy spitaleve AMERICAN HOSPITAL SHA dhe International Hospital SHA dhe shoqërisë PHARMA ONE SHPK. Nga të dhënat ka rezultuar se AMERICAN HOSPITAL ka realizuar blerje të produkteve farmaceutike nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, që përbën rreth X % të totalit të blerjeve për këtë produkt. Në zërin pajisje dhe materiale mjekësore, ky spital nuk ka realizuar blerje nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Në marrëdhënien tregtare me International Hospital SHA, na rezulton se ky spital ka realizuar blerje të produkteve farmaceutike nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, që përbën rreth X % të totalit të blerjeve. Në zërin pajisje dhe materiale mjekësore, ky spital ka realizuar blerje në

një vlerë shumë të vogël nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, që përbën vetëm X % të totalit të blerjeve.

Nga analiza e kryer vlerësohet se transaksioni nuk pritet të sjellë efekte antikonkurruese as në tregjet e lidhura me transaksionin.

Duke qenë se shoqëria target nuk ka ushtruar aktivitet dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike, pritet që transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë target nga z. Klodian Allajbeu nuk do të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të saj në tregun përkatës të produktit.

Transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga z. Klodian Allajbeu nuk pritet të kufizojë konkurrencën në tregun e tregtimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike në Shqipëri dhe as në tregjet e lidhura me transaksionin.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga Z. Klodian Allajbeu.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1181, Datë 05. 06. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK NGA SHOQËRIA UNION BANK SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA,

VËREN SE :

- I. Palët në transaksion dhe procedura**
konfidenciale
- II. Përqendrimi**
konfidenciale
- III. Analiza e konkurrencës**
konfidenciale

Nga sa me sipër, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 56 pika 1 dhe nenit 61, pika 1 germa d, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA.
2. Mbajtjen në monitorim të tregut të qerasë financiare nga IFJB për një periudhë 1 vjeçare nga dhënia e autorizimit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1182, Datë 05. 06. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË KANARIJA, D.O.O. NGA SHOQËRIA ORVAS D.O.O.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar, të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.,

VËREN SE :

1. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

Referuar dokumentit “Kontratë për blerjen e aksioneve të biznesit”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: ORVAS d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kroacisë, e cila operon në fushën e aktiviteteve të agjencive turistike në Kroaci, duke përfshirë marrjen me qera të varkave me vela, varka me motor dhe katamaranë. Ajo gjithashtu ofron akomodim në hotel dhe vila turistike në ishujt Hvar dhe Brač dhe prodhon verë dhe vaj ulliri. ORVAS d.o.o. është në pronësi dhe kontrollohet plotësisht nga ORBICO d.o.o., e cila së bashku me filialet e saj, përbëjnë ORBICO GROUP.

Në Shqipëri ORBICO GROUP operon përmes filialit të tij ORBICO SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, shoqëri shpërndarje dhe logjistike, që mbulon një numër të madh markash të njohura globalisht, duke filluar nga produktet e kujdesit të lëkurës dhe bukurisë, produktet ushqimore dhe jo-ushqimore, pajisjet teknike dhe elektrike, deri te produktet farmaceutike, cigaret, si dhe produktet e vajit motorik.

Pala shitëse: Silvana Šimunović, shtetase e huaj.

Shoqëria Target: KANARIJA, d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kroacisë, e cila ofron shërbime në sektorin detar në Kroaci. Qëllimi i aktivitetit të saj përfshin transportin detar dhe bregdetar, marrjen me qira të automjeteve të transportit ujor, transportin për nevojat e veta, shërbimet e menaxhimit, ankorimin e anijeve turistike, si dhe mirëmbajtjen dhe riparimin e anijeve dhe mjeteve të tjera lundruese.

KANARIJA, d.o.o. nuk kryen asnjë aktivitet tregtar në Shqipëri dhe nuk ka shoqëri apo asete të lidhura në Shqipëri.

2. Transaksioni

Më datë [...], pala blerëse ORVAS d.o.o. dhe pala shitëse Silvana Šimunović kanë nënshkruar “Kontratë për blerjen e aksioneve të biznesit”.

Shitësi ka pronësinë e plotë dhe të vlefshme të aksioneve të biznesit. Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshje, shitësi do të shesë dhe blerësi do të blejë dhe fitojë nga shitësi aksionet e biznesit të shoqërisë target, së bashku me të gjitha të drejtat e bashkangjitura dhe / ose të lidhura me to.

Në përfundimit të transaksionit, shoqëria target KANARIJA, d.o.o. do të zotërohet plotësisht nga shoqëria ORVAS d.o.o. dhe indirekt nga shoqëria ORBICO d.o.o.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimeve në turizmin detar dhe tregu për dhënien me qira të hapësirave komerciale dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

ORVAS d.o.o. operon në fushën e aktiviteteve të agjencive të udhëtimit dhe gjithashtu është e specializuar në shërbimet për marrjen me qira të varkave me vela, varka me motor dhe katamaranë. Për më tepër ORVAS d.o.o. operon në fushën e ofrimit të akomodimit në hotel dhe vilave turistike në ishujt Hvar dhe Brač. Përveç kësaj, ajo është e angazhuar në prodhimin e verës dhe vajit të ullirit si një aktivitet dytësor biznesi, duke prodhuar sasi të vogla për shitje brenda ORBICO Group.

Grupi ORBICO është prezente në Shqipëri nëpërmjet filialit të saj ORBICO SHPK, por zotëron filiale edhe në rajon si në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Bullgari.

ORBICO SHPK operon kryesisht në tregun e produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) dhe tregun e bukuri në vend, por pjesa që zë ORBICO SHPK në totalin e tregut të produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) është rreth XX%.

KANARIJA, d.o.o. operon në ofrimin e shërbimeve që lidhen me trafikun ujor në territorin e Kroacisë. Qëllimi i aktivitetit të tij përfshin transportin detar dhe bregdetar, marrjen me qira të automjeteve të transportit ujor, transportin për nevojat e veta, shërbimet e menaxhimit, ankorimin dhe ankorimin e anijeve turistike, si dhe mirëmbajtjen dhe riparimin e anijeve dhe automjeteve të tjera lundruese. Gjithashtu, KANARIJA, d.o.o. është e angazhuar në dhënie me qira të ambienteve tregtare në Kroaci.

Target nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Nëpërmjet realizimit të këtij transaksioni, ORVAS d.o.o. synon të zgjerojë biznesin e tij në Kroaci në ofrimin e shërbimit të turizmit detar dhe marrjen me qira të pasurive të paluajtshme. Ai planifikon të diversifikojë ofertën e tij në sektorin e turizmit luksoz, të rrisë pozicionin e tij në treg dhe të arrijë efekte sinergjike duke integruar shërbimet ekzistuese me operacionet e target me qëllim optimizimin e operacioneve, rritjen e konkurrencës dhe arritjen e rritjes afatgjatë në sektorin e turizmit luksoz.

Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë KANARIJA, d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1183, Datë 05. 06. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË
NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA INTER STOCK Albania
SHPK, NGA SHOQËRITË AGNA SHA DHE INTER STOCK SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA DHE INTER STOCK SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1: AGNA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-export të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore dhe blegtorale, prodhim e shitje pije alkoolike; në fushën e investimit në ndërtim, në

fushën e shitblerjes së trojeve për ndërtim, për turizëm, fshatra turistike, moteleri dhe hoteleri; tregtim import - eksport i produkteve dhe nënprodukteve të duhanit; shitblerje, marrje ose dhënie me qera të pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme; veprimtari trajnuese dhe certifikuese të punonjësve të administratës publike, punonjësve të institucioneve arsimore; auditimi, mbikëqyrja dhe certifikimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare për institucionet në përgjithësi dhe/ose personelin e tyre në veçanti etj.

Shoqëria AGNA SHA kontrollohet nga z. Kosta Sotiri me 32.5% të aksioneve, z. Vasil Naçi me 32.5% të aksioneve, z. Kristo Naçi me 30% të aksioneve, z. Aleksandër Naçi me 5% të aksioneve.

Sipas të dhënave të QKB shoqëria AGNA SHA zotëron kuota në shoqëri të cilat operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike; në tregun e ndërtimit dhe në tregun e hotelierisë.

Pala 2: INTER STOCK SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës dhe adrese në Prishtinë. Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është :Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, gëzofit, këpucët dhe artikujt e lëkurës, dhe aktivitete të tjera në, tregti me shumicë dhe pakicë të veshjeve, këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara; artikuj elektronike dhe elektroshtepiake në dyqane të specializuara; magazinim, ruajtje dhe transport mallrash, etj.

Referuar të dhënave të regjistrit të Agjencisë së Biznesit në Kosovë, rezulton se shoqëria INTER STOCK SHPK zotërohet XX% nga z. Armend Kadriu dhe XX% nga z. Edmond Kadriu.

Ndërmarrje e Përbashkët (JV): INTER STOCK Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Hapja njësisë tregtare dhe atyre ndihmëse, për tregtimin me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, si dhe çdo produkti tjetër të ngjashëm me përshkrimin e mësipërm. Çdo lloj veprimtarie tjetër tregtare që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin.

II. Transaksioni

Kuvendi i Aksionareve të shoqërisë INTER STOCK SHPK dhe Asambleja e Aksionareve të shoqërisë AGNA SHA, me vendimet respektive, kanë vendosur për themelimin bashkërisht të një shoqërie të re, me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 1,000,000 lekë, i ndarë në dy kuota, ku secili nga ortakët themelues do të zotërojë:

- Shoqëria AGNA SHA, do të ketë në pronësi një kuotë, që do të përbëjë 51% të kapitalit të shoqërisë së re....
- Shoqëria INTER STOCK SHPK, do të ketë në pronësi një kuotë, që do të përbëjë 49% të kapitalit të shoqërisë së re....

Emri i shoqërisë së re do të jetë INTER STOCK Albania SHPK dhe aktiviteti kryesor i saj do të jetë: *Hapja e njësisë tregtare dhe atyre ndihmëse për tregtimin me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, si dhe*

çdo produkti tjetër të ngjashëm me përshkrimin e mësipërm. Çdo lloj veprimtarie tjetër tregtare që nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Kohëzgjatja e shoqërisë dhe aktiviteti i saj do të jenë për një afat të pacaktuar.

Me datë [...], palët kanë hartuar dhe nënshkruar statutin e shoqërisë INTER STOCK Albania SHPK, në të cilin është përcaktuar sa më sipër.

Referuar Statutit të ndërmarrjes së përbashkët, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë $\frac{3}{4}$ e votave përsa i përket: ndryshimeve në statut, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarja e fitimit, organizimi dhe prishja e shoqërisë, përcaktimi i politikave tregtare, planeve dhe strategjive të biznesit, kryerja e investimeve të paplanifikuara, organograma, shpërblimet dhe pagat e punonjësve etj.

Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, INTER STOCK Albania SHPK nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria AGNA SHA, pjesën më të madhe të të ardhurave e ka realizuar nga aktivitetet e tregtimit të cigareve, mallrave ushqimore dhe jo ushqimor etj dhe nuk ushtron aktivitet në tregun përkatës të prekur nga transaksioni.

Shoqëria INTER STOCK SHPK nuk zotëron ndonjë filial/ degë në Shqipëri.

Palët kanë deklaruar se krijimi i ndërmarrjes së përbashkët ka si qëllim hapjen e dyqaneve të specializuar për shitjen e veshjeve, të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, duke mundësuar hyrjen e një konkurrenti të ri në treg.

Tregu i shitjes me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, karakterizohet nga një numër i madh ofruesish, numër i madh produktesh me dhe pa markë dhe krijimi i ndërmarrjes së përbashkët INTER STOCK Albania SHPK nuk pritet të krijojë shqetësime për konkurrencën nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës të produktit në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, INTER STOCK Albania SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA DHE INTER STOCK SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1184, Datë 05. 06. 2025

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE AGNA SHA DHE INTER STOCK SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDË AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, TË SHOQËRISË INTER STOCK Albania SHPK”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së ortakëve të shoqërisë INTER STOCK Albania SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar për krijimin e shoqërisë së përbashkët, me funksione të plota.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53, nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK, nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK,

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK nga shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 470 prot. i AK, datë 13.05.2025 “Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimit”, ku jemi njoftuar se shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK kanë themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, INTER STOCK Albania SHPK, me qëllim tregtimin e produkteve të veshjeve, të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës dhe pala njoftuese ka dorëzuar dokumentacionin e parashikuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të

ndërmarrjeve”, sipas së cilës Sekretariati filloi procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Më datë [...], palët kanë hartuar dhe nënshkruar statutin e shoqërisë INTER STOCK Albania SHPK.

Statuti i shoqërisë ka përcaktuar themelimin bashkërisht të një shoqërie të re, me përgjegjësi të kufizuar, ku kapitali themeltar i shoqërisë do të përbëhet nga kontributi në para i Ortakëve Themelues në vlerën totale 1,000,000 lekë, i përbëhet nga 2 kuota, ku 1 kuotë i përket shoqërisë INTER STOCK SHPK përfaqëson 49% të kapitalit dhe 1 kuotë i përket shoqërisë AGNA SHA përfaqëson 51% të kapitalit.

Emri i shoqërisë së re do të jetë INTER STOCK Albania SHPK dhe aktiviteti kryesor i saj do të jetë: Hapja e njësisë tregtare dhe atyre ndihmëse për tregtimin me pakicë të veshjeve të të gjitha llojeve dhe materialeve, të këpucëve, aksesoreve të ndryshëm dhe produkteve të kozmetikës, si dhe çdo produkti tjetër të ngjashëm me përshkrimin e mësipërm. Çdo lloj veprimtarie tjetër tregtare që nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë $\frac{3}{4}$ e votave përsa i përket: ndryshimeve në statut, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarja e fitimit, organizimi dhe prishja e shoqërisë, përcaktimi i politikave tregtare, planeve dhe strategjive të biznesit, kryerja e investimeve të paplanifikuara, organograma, shpërblimet dhe pagat e punonjësve etj.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK, detyrimin për njoftim e kanë patur shoqëritë AGNA SHA dhe INTER STOCK SHPK.

Në zbatim të nenit 12, pika 2 e ligjit, palët kanë patur detyrimin për njoftim sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, brenda 30 ditëve duke filluar nga data 20.03.2025.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në

masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

Referuar nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, rezulton se xhiroja e shoqërive palë në marrëveshje është në vlerën rreth 160 miliard lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota INTER STOCK Albania SHPK nga ortakët themelues të saj, vendosjen e gjobës mbi:
 - a. shoqërinë AGNA SHA, në masën XXX ([...]) lekë,
 - b. shoqërinë INTER STOCK SHPK, në masën XXX ([...]) lekë,
 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
 3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1185, Datë 05. 06. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ECO RICIKLIM SHPK NGA SHOQËRIA ANAMARK SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: ANAMARK SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: qiradhënie, tregtim të artikujve ushqimore, etj; veprimtari të lidhura ose të ngjashme me objektin e shoqërisë.

Shoqëria ANAMARK SHPK zotërohet 100% nga z. Klodian Allajbeu, i cili zotëron kuota në shoqëritë WESTERN BALKANS UNIVERSITY SHPK, FUTURE CEMENT SHPK, Con Energy

Albania SHPK, ENERGY PROJECT SHPK, MEDICAL RECYCLING SHPK dhe Med Lab SHPK, shoqëri të cilat kanë aktivitet në: shitje, blerje, dhënie/marrje me qira të pronave të paluajtshme, prodhim, realizim, impiante prodhimi energjie elektrike, trajtimi, riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve spitalore, hapja dhe menaxhimi i qendrave të përpunimit të mbetjeve spitalore, riciklimi i mbetjeve spitalore, shërbimi spitalor, arsimi i lartë, tregtimi i pajisjeve mjekësore dhe laboratorike, etj.

Shoqëria ANAMARK SHPK zotëron kuota në shoqëritë: MED–RAD SHPK dhe EKMA ALBANIA SHPK, të cilat kanë si aktivitet: transport tokësor dhe detar mallrash dhe udhëtarësh, import - eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale, ushqimore, materiale ndërtimi etj, shitje, blerje, dhënie / marrje me qira të pronave të paluajtshme etj.

Pala Shitëse: Z. Arbër Teqja, shtetas shqiptar.

Shoqëria Target: ECO RICIKLIM SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Pastrim, grumbullim, përpunim, transport dhe asgjësim të mbetjeve spitalore apo mbetjeve të tjera të ngjashme, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuar me ligj; import – eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve dhe mjeteve që përdoren për transportin, magazinimin e këtyre lloj mbetjesh; shërbim 3DDD (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim), pastrim të ambienteve të ndryshme, prodhuese, tregtare, magazina, hotele, spitale, konvikte etj, si dhe import – eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të dezinfektuesve dhe produkteve të tjera që i shërbejnë këtij qëllimi. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Shoqëria ECO RICIKLIM SHPK para transaksionit zotërohej 70% nga z. Arbër Teqja dhe 30% nga z. Ervin Meçe.

II. Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë ANAMARK SHPK (blerësi), Z. Arbër Teqja (shitësi) dhe dhënësit të pëlqimit, është lidhur “Kontratë për shitjen e kuotës”, e cila u nënshkrua më datë 27 shkurt 2025.

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi është ortak i shoqërisë target ECO RICIKLIM SHPK, në të cilën zotëron 1 (një) kuotë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes në masën 70% në kapitalin bazë të kësaj shoqërie. Shitësi kërkon të shesë kuotën e zotëruar prej tij në shoqërinë target dhe blerësi është i interesuar të blejë atë, sipas kushteve, afateve dhe modaliteteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Referuar Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK, më saktësisht nenit 6 “Asambleja e Përgjithshme”, organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë target është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe *vendimet e Asamblesë duke patur të drejtën e votës në raport me vlerën nominale të kuotës së tij.*

Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë *ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të numrit total të votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës*. Për të vendosur shpërndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm ose të përfaqësuar ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të numrit total të votave. Vendimi merret me votën pro të të paktën 75% të ortakëve të pranishëm.

Nga sa më sipër, me nënshkrimin e “Kontratë për shitjen e kuotës” dhe në përfundim të transaksionit të njoftuar, kapitali i regjistruar i shoqërisë target ECO RICIKLIM SHPK do të zotërohet nga shoqëria ANAMARK SHPK me 1 (një) kuotë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 70% në kapitalin e regjistruar të shoqërisë dhe z. Ervin Meçe me 1 (një) kuotë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 30% në kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Për sa më sipër dhe referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

ANAMARK SHPK, ushtron aktivitet në tregun e qiradhënies, tregtimit të artikujve ushqimore, etj.; veprimtari të lidhura ose të ngjashme me objektin e shoqërisë dhe zotërohet plotësisht nga z. Klodian Allajbeu, i cili në mënyrë direkte dhe indirekte zotëron kuota në shoqëri si që kanë aktivitet në: shërbimi i arsimit të lartë, shitje, blerje, dhënie/marrje me qira të pronave të paluajtshme, prodhim, realizim, impiante prodhimi energjie elektrike, trajtimi, riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve spitalore, hapja dhe menaxhimi i qendrave të përpunimit të mbetjeve spitalore, etj.

Z. Klodian Allajbeu zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë MEDICAL RECYCLING SHPK, një shoqëri e cila ka si objekt të veprimtarisë trajtimin, riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve spitalore.

Shoqëria target, ECO RICIKLIM SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt veprimtarie: Pastrim, grumbullimi, përpunim, transport dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore apo mbetjeve të tjera të ngjashme, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me ligje. Import-Export dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve dhe mjeteve që përdoren për transportin, magazinimin, të këtyre lloj mbetjesh. Shërbim 3DDD (Dezinfektim,

Dezinsektim, Deratizim), pastrimi, të ambienteve të ndryshme, prodhuese, tregtare, magazinave, hotele, spitale, konvikte, etj., si dhe import-export dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë i dezinfektuesve dhe produkteve të tjera, që i shërbejnë këtij qëllimi.

Referuar informacionit të depozituar nga pala njoftuese, shoqëria ECO RICIKLIM SHPK realizon të ardhura vetëm nga shërbimi i pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore.

Sipas të dhënave të deklaruara nga palët dhe referuar të ardhurave të realizuar nga shoqëria dhe konkurrentët e saj me të afërt në tregun përkatës, konstatohet se ECO RICIKLIM SHPK zotëron 27% të tregut përkatës të produktit.

Përftimi i kontrollit indirekt të shoqërisë target, ECO RICIKLIM SHPK nga z. Allajbeu, nëpërmjet shoqërisë ANAMARK SHPK, do të krijojë një mbivendosje me aktivitetin e shoqërisë MEDICAL RECYCLING SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal në këtë treg.

Nga dokumentacioni i administruar, u konstatua se shoqëria MEDICAL RECYCLING SHPK nuk ushtron aktivitet prej shumë vitesh dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun e ofrimit të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, përpunimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, dhe për këto arsye, pritet që transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK nuk do të sjellë ndryshime në tregun përkatës të produktit, pasi nuk ka ndryshim (zvogëlim) të numrit të konkurrentëve dhe as rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjes si rrjedhojë e realizimit të përqendrimit.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ECO RICIKLIM SHPK nga shoqëria ANAMARK SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1186, Datë 26. 06. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË MD GREEN ENERGY SHPK NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë shitje pasuri e luajtshme”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: 4 A-M SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të veprimtarisë së saj: Punime elektrike, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve elektrike, import eksportin e tyre, prodhim dhe tregtim betoni dhe inerte, tregtim me shumicë dhe me pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimore,

elektroshtëpiake, konfeksione, kozmetike. Tregtim dhe shitje produkteve artizanati, kimike, tekstile, artikuj plastike. Tregtim produkteve të gatshme me shumicë e pakicë, etj. Në fushën e ndërtimit, të ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, mbi 2 kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Në fushën e projektimit dhe zbatimin duke përfshirë, por pa u kufizuar i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, urave dhe veprave të artit, si dhe punime inxhinierike, topografike dhe hidrologjike, inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë, etj.

Shoqëria 4 A-M SHPK, zotëron XX% të kapitalit në shoqërinë GREEN ENERGY PLUS SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike, fotovoltaike, dhe gjithë llojeve të tjera të prodhimit të energjisë dhe veprave ndihmëse në gjithë territorin e Shqipërisë. Prodhim energjie fotovoltaike, hidrike, solare, etj; Shit-blerje energjie fotovoltaike, solare, hidrike, etj.

Pala shitëse:

- **Shoqëria I.D.K-KONSTRUKSION SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Sinjalistikë rrugore vertikale, horizontale, siguri rrugore, ndriçuese dhe jo ndriçuese, studim, projektim, prodhim, montim, tregtim dhe zbatim të tyre. Import-eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të sinjalistikës rrugore, targa prokate, metale për skrap, veshjeve të punës, pajisje dhe veshje për parandalimin e aksidenteve, për sigurimin teknik në pune, vegla pune të pajisjeve dhe pjesëve industriale, telekomunikacioni, pajisje elektrike, panele diellore, etj.
- **Shoqëria DABAR SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Import eksport me shumicë e pakicë të artikujve industrial, materialeve elektrike, materialeve të ndërtimit, materialeve elektronike, mekanike, pajisjeve elektrike, pajisjeve elektronike, mekanike, pjesë këmbimi automjetesh, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimore, elektroshtëpiake, konfeksione, kozmetike të materialeve të ndërtimit, elektrike elektronike, mekanike, pjesë këmbimi automjetesh, prodhim të artikujve industrial, etj.

Shoqëria Target: MD green energy SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Prodhim të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale, e biomasës ose biogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane. b) Studim dhe projektim të hidrocentraleve, centraleve apo impianteve, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjisë, që gjendet në natyrë dhe që janë të rinovueshme. c) Ndërtim, rehabilitim, modernizim të hidrocentraleve, të centraleve dhe të impianteve, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjive që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme. d) Operim, shitje të energjisë elektrike klientëve dhe blerje të energjisë elektrike nga operatore të ndryshëm privat apo shtetëror, brenda

dhe jashtë vendit. e) Transmetim të energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion, i cili përfshin edhe transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

Shoqëria kontrollohej nga shoqëritë I.D.K-KONSTRUKSION SHPK e DABAR SHPK, të cilat zotëronin secili nga 1 kuotë, që përbënte 50% të kapitalit.

Referuar QKB, shoqëria nuk zotëron licenca aktive dhe as shoqëri të tjera, ndërsa referuar pasqyrave financiare shoqëria nuk ka realizuar të ardhura për vitin 2023.

II. Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë 4 A-M SHPK (blerësi) dhe shoqërive I.D.K-KONSTRUKSION SHPK e DABAR SHPK (shitësit), është nënshkruar dokumenti “ Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme (kuota kapitali)”, më datë 28 prill 2025.

Referuar objektit të kontratës, shitësit, shoqëritë I.D.K-KONSTRUKSION SHPK e DABAR SHPK, zotëruarës secili të 50% të kapitalit të shoqërisë target, do të shesin blerësit, shoqërisë 4 A-M SHPK kuotat e tyre, që përbëjnë së bashku 100% kuotën e shoqërisë target MD green energy SHPK.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target do të zotërohet tërësisht nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Për sa më sipër dhe referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimin nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria 4 A-M SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt kryesor aktiviteti: punime & instalime elektrike; tregtim, import - eksport materiale; ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile, etj.

4 A-M SHPK zotëron XX % të kapitalit në shoqërinë GREEN ENERGY PLUS SHPK, me objekt aktiviteti: Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike, fotovoltaike, dhe gjithë llojeve të tjera të prodhimit të energjisë dhe veprave ndihmëse në gjithë territorin e Shqipërisë. Prodhim energjie fotovoltaike, hidrike, solare, etj. Shit-blerje energjie fotovoltaike, solare, hidrike, etj. Kjo shoqëri nuk ka realizuar të ardhura gjatë viteve të fundit.

Shoqëria target, MD green energy SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Prodhim të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale, e biomasës ose biogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane; b) Studim dhe

projektim të hidrocentraleve, centraleve apo impianteve, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjisë, që gjendet në natyre dhe që janë të rinovueshme; c) Ndërtim, rehabilitim, modernizim të hidrocentraleve, të centraleve dhe të impianteve, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjive që gjenden në natyre dhe që janë të rinovueshme; d) Operim, shitje të energjisë elektrike klientëve dhe blerje të energjisë elektrike nga operatorë të ndryshëm privat apo shtetëror, brenda dhe jashtë vendit; e) Transmetim të energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion, i cili përfshin edhe transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

Referuar QKB, rezulton se shoqëria nuk zotëron licenca aktive dhe as shoqëri të tjera, ndërsa referuar pasqyrave financiare të shoqërisë, ajo nuk ka realizuar të ardhura.

Përftimi i kontrollit të shoqërisë target, MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK, do të krijojë një mbivendosje të aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal në këtë treg.

Nga dokumentacioni i administruar, u konstatua se shoqëria MD green energy SHPK nuk ushtron aktivitet dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, shoqëria e kontrolluar nga 4 A-M SHPK, GREEN ENERGY PLUS SHPK, nuk ka patur aktivitet në tregun përkatës dhe për këto arsye, pritet që transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK nuk do të sjellë ndryshime në tregun përkatës të produktit, pasi nuk ka ndryshim (zvogëlim) të numrit të konkurrentëve në tregun përkatës dhe as rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjes si rrjedhojë e realizimit të përqendrimit.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë MD green energy SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1187, Datë 26. 06. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË O-SP ALBANIA SHA NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4 A-M SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse: 4 A-M SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj; Punime elektrike, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve elektrike, import eksportin e tyre, prodhim dhe tregtim betoni dhe inerte, tregtim me shumicë dhe me pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial,

ushqimore, elektroshtepiake, konfeksione, kozmetike. Tregtim dhe shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile, artikuj plastike. Tregtim produktesh të gatshme me shumicë e pakicë, etj. Në fushën e ndërtimit, të ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, mbi 2 kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Në fushën e projektimit dhe zbatimin duke përfshirë, por pa u kufizuar i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, urave dhe veprave të artit, si dhe punime inxhinierike, topografike dhe hidrologjike, inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë etj.

Shoqëria 4 A-M SHPK, zotëron kuota në shoqëritë MD green energy SHPK dhe GREEN ENERGY PLUS SHPK.

Pala Shitëse: Z. A.M., shtetas shqiptar, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë target.

Shoqëria Target: O-SP Albania SHA, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Import, eksport, shitje dhe tregtim me shumicë dhe pakicë, transport dhe magazinimi i gjithë produkteve të naftës dhe nënprodukteve të saj, gazit dhe produkteve energjetike. Import, transport, tregtim dhe magazinimi i vajrave lubrifikante. Shitje pjesëve të këmbimit, gomave, riparim makinash. Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të motorit. Riparim dhe mirëmbajtje karrocierie. Riparim dhe mirëmbajtje impianti elektrik. Riparim dhe mirëmbajtje e gomave. Mbledhje, depozitim, shkatërrimi i mjeteve rrugore ose i pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

II. Përqendrimi

Më datë [...] është nënshkruar dokumenti “Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme (aksione)” ndërmjet shoqërisë 4 A-M SHPK (blerësi) dhe z. AM (shitësit), si palë të kësaj kontrate.

Referuar objektit të kontratës, shitësit, zotërues i 100% të aksioneve të shoqërisë target, do ti shesë blerësit, shoqërisë 4 A-M SHPK aksionet e tij, që përbëjnë 100% kapitalit të shoqërisë target, O-SP Albania SHA.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target do të zotërohet tërësisht nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i përfuturit të kontrollit të vetëm të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4A-M SHPK përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i import, transport, tregtim dhe magazinim i vajrave lubrifikante. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë 4 A-M SHPK, u evidentua se aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është, punime & instalime elektrike, tregtim imp-exp materialesh, ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj

Shoqëria target, O-SP Albania SHA ushtron aktivitetin në tregun e importit dhe shitjes së vajrave lubrifikantë dhe klienti i vetëm i saj është shoqëria blerëse.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në tregje të ndryshme dhe për më tepër shoqëria target ka patur marrëdhënie tregtare me shoqërinë 4 A-M SHPK.

Nëpërmjet këtij transaksioni, pala blerëse synon të përmirësojë efencën ekonomike brenda zinxhirit të shërbimeve të riparimit të automjeteve, duke lehtësuar koordinimin më të mirë ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun përkatës të produktit.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë O-SP Albania SHA nga shoqëria 4 A-M SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1188, Datë 26. 06. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TURE D.O.O. NGA
SHOQËRIA ORVAS D.O.O.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.,

VËREN SE :

1. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfutimit të kontrollit të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitblerjen e aksioneve të biznesit”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: ORVAS d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kroacisë, e cila operon në fushën e aktiviteteve të agjencive turistike në Kroaci, duke përfshirë marrjen me qera të varkave me vela, varka me motor dhe katamaranë. Ajo gjithashtu ofron akomodim në hotel dhe vila turistike në ishujt Hvar dhe Brač dhe prodhon

verë dhe vaj ulliri. ORVAS d.o.o. është në pronësi dhe kontrollon plotësisht nga ORBICO d.o.o., e cila së bashku me filialet e saj, përbëjnë ORBICO GROUP.

ORBICO GROUP operon në Shqipëri përmes filialit të tij ORBICO SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, shoqëri shpërndarje dhe logjistike, që mbulon një numër të madh markash të njohura globalisht, duke filluar nga produktet e kujdesit të lëkurës dhe bukurisë, produktet ushqimore dhe jo-ushqimore, pajisjet teknike dhe elektrike, deri te produktet farmaceutike, cigaret, si dhe produktet e vajit motorik.

Pala shitëse: z. I. B., shtetas i huaj.

Shoqëria Target: TURE d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kroacisë, e cila operon në fushën e turizmit dhe ofrimit të shërbimit të akomodimit në hotel, në Kroaci. Ajo afron akomodim në hotelin e saj Hotel Lipa në Brač.

TURE d.o.o. nuk ka prani të drejtpërdrejtë apo indirekte në Shqipëri.

2. Transaksioni

Më datë [...], pala blerëse ORVAS d.o.o. dhe pala shitëse z. I.B. kanë nënshkruar “Marrëveshje për shitblerjen e aksioneve të biznesit”.

Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshje, shitësi shet dhe transferon drejt blerësit dhe blerësi blen dhe merr nga shitësi aksionet e biznesit të shoqërisë target të lira nga çdo barrë, së bashku me të gjitha të drejtat e bashkangjitura dhe / ose të lidhura me to në finalizim.

Detyrimet e palëve për të vazhduar me finalizimin e kontratës, i nënshtrohen plotësisht kushteve paraprahe.

Në përfundimit të transaksionit të propozuar, shoqëria target TURE d.o.o. do të zotërohet plotësisht nga shoqëria ORVAS d.o.o. dhe indirekt nga shoqëria ORBICO d.o.o.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i prekur nga transaksioni do të konsiderohet tregu i shërbimeve të akomodimit në hotel, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.

ORVAS d.o.o. operon në fushën e aktiviteteve të agjencive të udhëtimit dhe gjithashtu është e specializuar në shërbimet për marrjen me qira të varkave me vela, varka me motor dhe katamaranë. Për më tepër ORVAS d.o.o. operon në fushën e ofrimit të akomodimit në hotel dhe vilave turistike në ishujt Hvar dhe Brač. ORVAS d.o.o. është pjesë e ORBICO Group.

Grupi ORBICO është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij ORBICO SHPK, i cili operon kryesisht në tregun e produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) dhe tregun e bukurisë në vend. Grupi ORBICO zotëron filiale edhe në rajon si në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Bullgari.

TURE d.o.o. operon në fushën e ofrimit të shërbimeve të akomodimit në hotel në Kroaci. Target nuk është prezent dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje horizontale dhe vertikale midis aktiviteteve të palëve në Shqipëri, për faktin se palët nuk janë të pranishme në tregun përkatës në Shqipëri dhe për këto arsye kushtet e konkurrencës në treg do të mbeten të pandryshuara pas realizimit të transaksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë TURE d.o.o. nga shoqëria ORVAS d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1189, Datë 26. 06. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR
NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FASHION GROUP
ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA ALBI HOLDING SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar, të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni, i propozuar, i përfimit të kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitblerjen e 100% të kuotave të shoqërisë “Fashion Group Albania” SHPK”, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: ALBI HOLDING SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: pjesëmarrja, menaxhimi, ndjekja dhe kontrolli i kuotave dhe aksioneve në pronësinë e shoqërive ku është ortakë dhe të shoqërive të tjera, ku ajo gëzon të drejtën e pronësisë, shpërndarje dhe investime të dividendëve dhe fitimeve nga pjesëmarrjet, investime në instrumente financiare etj.

ALBI HOLDING SHPK është pjesë e ALBI GROUP, i themeluar në Kosovë, i cili zotëron rrjetin e dyqaneve me produkte të modës që operon në Kosovë dhe rajon, duke përfaqësuar markat ndërkombëtare si: Celio, Chaussea, Okaidi, Mango, Springfield, Ozdilek, Geox, Gant, Timberland, Hugo Boss, Sportina Armani Exchange, Tom Tailor, XYZ, UGG, Plein Sport, Orsay, Dan John, Parfois, Boggi.

ALBI HOLDING SHPK zotërohet XX % nga z. Tahir Humolli, XX % nga z. Sutki Humolli, XX % nga z. Nexhat Humolli, XX % nga z. Nehat Humolli dhe XX% nga z. Betim Humolli. Ortakët e shoqërisë, z. Tahir Humolli zotëron kuota në shoqërinë *ALBI SHOPPING SHPK*; z. Sutki Humolli zotëron kuota në shoqëritë: *Albi Commerce SHPK dhe Albi Asset Investments L.L.C.*; z. Nexhat Humolli zotëron kuota në shoqërinë *Albi Fashion SHPK* dhe z. Betim Humolli zotëron kuota në shoqërinë *Albi FashionRetail SHPK*.

Pala shitëse: Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, aktiv në sektorin e industrisë së pasurive të paluajtshme, shitjes me shumicë dhe pakicë, veprimtari bankare, miniera dhe shkrirja, logjistika, turizmi, energjia etj.

Aksionar i kësaj shoqërie është Z. Samir Mane me 100% të kuotave.

Shoqëria Target: Fashion Group Albania SHPK SHPK (FGA) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka për objekt aktiviteti importi – eksporti, shitja me shumicë e produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve të të gjitha llojeve; çelja dhe administrimi i pikave të tregtimit me pakicë të produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve të të gjitha llojeve nën franchising apo nën markën/ at e saj; shitja me shumicë e pakicë e mallrave industriale dhe jo ushqimore; shitja, blerja, dhënia me qera e pasurive të paluajtshme; menaxhimi i qendrave tregtare, bareve, restoranteve etj.

Shoqëria operon përmes rrjetit të saj të dyqaneve nën markën ndërkombëtare “Aldo”, “Carpisa”, “Cortefiel”, “Geox”, “Mango”, “Okaidi”, “Parfois”, “Prenatal”, “Springfield”, “Woman Secrets” (“Markat Ndërkombëtare”) brenda territorit të Shqipërisë. Veprimtaria e shoqërisë përfshin gjithashtu shitjen me pakicë nëpërmjet platformave online e produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve të të gjitha llojeve, import-eksportin, shitjen me shumicë e produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve të të gjitha llojeve.

II. Transaksioni

Më datë [...], shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK në cilësinë e shitësit dhe shoqëria ALBI HOLDING SHPK në cilësinë e blerësit, kanë nënshkruar “Kontratë për shitblerjen e 100% të kuotave të shoqërisë “Fashion Group Albania” SHPK”.

Referuar objektit të kësaj kontrate, shitësi do të shesë 100% kuotën e shoqërisë target Fashion Group Albania SHPK (së bashku me të gjitha të drejtat dhe interesat që u lidhën me të në datën e finalizimit të transaksionit) tek blerësi dhe blerësi do të blejë 100% kuotën e shoqërisë target nga shitësi, të pastër dhe të lirë nga çdo barrë, kundrejt pagesës së çmimit të shitjes.

Detyrimi i blerësit për të blerë kuotën e shoqërisë target dhe detyrimi i shitësit për ta shitur kuotën sipas kontratës, i nënshtrohet dhe kushtëzohet nga përmbushja e kushteve të përcaktuara në nenin 6 dhe 7 të kontratës, ose heqjes dorë me shkrim prej tyre brenda afatit të parashikuar për Finalizimin e Transaksionit. Kjo kontratë do të konsiderohet e pavlefshme dhe pa fuqi juridike nëse nuk janë përmbushur të gjitha kushtet ose nëse prej kushteve nuk është hequr dorë me shkrim nga pala e cila përfiton prej tyre sipas afateve të përcaktuara në Marrëveshje.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë të produkteve tekstile dhe të modës, përfshirë veshjet, këpucët dhe aksesorët. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu shqiptar i produkteve të modës është i fragmentuar, me një numër të madh operatorësh, si Inditex Group, LC Waikiki, De Facto dhe rrjete të tjera vendase (dyqane të specializuara). Bazuar në vlerësimet e Fashion Group Albania SHPK, tregu i modës për veshje dhe këpucë, në Shqipëri, vlerësohet në rreth 400 milion euro në vitin 2025 dhe pjesa e tregut që zotëron shoqëria target në tregun përkatës është e vogël, pa ngritur shqetësime për konkurrencën.

Fashion Group Albania SHPK operon përmes rrjetit të saj të dyqaneve nën markën ndërkombëtare “Aldo”, “Carpisa”, “Cortefiel”, “Geox”, “Mango”, “Okaidi”, “Parfois”, “Prenatal”, “Springfield”, “Woman Secrets” (“Markat Ndërkombëtare”) brenda territorit të Shqipërisë. Veprimtaria e shoqërisë përfshin gjithashtu shitjen me pakicë nëpërmjet platformave online e produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve të të gjitha llojeve, import-eksportin, shitjen me shumice e produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesoreve të të gjitha llojeve.

ALBI HOLDING SHPK është pjesë e Albi Group, i cili zotëron një rrjet dyqanesh me produkte të modës, që operojnë në Kosovë dhe rajon, duke përfaqësuar markat ndërkombëtare si Celio,

Chaussea, Okaidi, Mango, Springfield, Ozdilek, Geox, Gant, Timberland, Hugo Boss, Sportina Armani Exchange, Tom Tailor, XYZ, UGG, Plein Sport, Orsay, Dan John, Parfois, Boggi.

Duke qenë pjesë e një grupi shoqërisht që ka një portofol franchizash të konsiderueshëm në Kosovë, vlerësohet se nëpërmjet këtij transaksioni, ALBI HOLDING SHPK do të ketë mundësi të përmirësojë marrëdhëniet me dhënësit e franchizës dhe të negociojë kushte dhe çmime më të favorshme, duke sjellë çmime më konkurruese.

Deri më tani, Albi Group (pjesë e së cilës është ALBI HOLDING SHPK) ka qenë e fokusuar në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Kjo blerje do ti mundësojë hyrjen në tregun shqiptar me një infrastrukturë të gatshme dhe të konsoliduar.

Edhe pse shoqëritë ALBI HOLDING SHPK, si pjesë e Albi Group, dhe Fashion Group Albania SHPK operojnë në të njëjtin treg përkatës produkti, transaksioni nuk do të sjellë ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri pasi Albi Group është aktive vetëm në Kosovë, në tregun e shitjes me pakicë të produkteve tekstile dhe të modës, përfshirë veshjet, këpucët dhe aksesoret, ndërsa FGA është aktiv vetëm në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Fashion Group Albania SHPK nga shoqëria ALBI HOLDING SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1190, Datë 26. 06. 2025

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifar për ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat SHA:

VËREN SE:

1. Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) nëpërmjet shkresës nr. 564 prot., datë 13.06.2025, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 322/1 prot., datë 09.06.2025, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për nivel të ri të tarifave të ndërmarrjes rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat SHA, e cila ka paraqitur kërkesë për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, në të gjithë zonën e shërbimit të saj, më datë 28.06.2024, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga vlerësimi i projekt-vendimit “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA” dhe relacionit përkatës, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), për të gjitha njësitë, të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja Rajonale UK Berat SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese sipas:
 - Vendimit të KKRR nr. 48, datë 10.10.2019 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjiellës kanalizime Berat-Kuçovë SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 34, datë 11.05.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur për shoqërinë ujësjiellës kanalizime Skrapar SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 8, datë 08.02.2019 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur për shoqërinë ujësjiellës kanalizime Poliçan SHA.
5. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifar, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrijë në fund të vitit 2027, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballojë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.
6. Ndërmarrja Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes, dhe si rrjedhojë objektivi i saj është fillimisht mbulimi i kostove të tyre. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese, e riorganizuar në një njësi rajonale.
7. Në vijim të kërkesës së ndërmarrjes rajonale UK Berat SHA, ERRU e ka vlerësuar të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifar për tarifat variabël të shërbimit FU dhe KUN për këtë ndërmarrje, por jo në nivelet e propozuara prej saj. Është pranuar një rritje jo shumë e madhe, por e konsideruar racionale të niveleve të tarifave për zonat rurale me qëllim unifikimin tarifar

në mënyrë që shoqëria të mundësojë ofrimin e cilësisë më të mirë të mundshme me një çmim të arsyeshëm dhe të rrisë qëndrueshmërinë e saj financiare, duke marrë në konsideratë përmbushjen e kriterit të përballueshmërisë së faturës mujore.

8. Në variantin e propozuar, është pranuar si i arsyeshëm propozimi i shoqërisë për KUN për klientët familjarë dhe jo familjarë me qëllim unifikimin e e kësaj tarife për të gjithë zonën. Gjithashtu, tarifa volumetrike për shërbimin FU për klientët familjarë është vendosur e unifikuar për gjithë zonën e shërbimit nga ndërmarrja rajonale UK Berat SHA, ndërsa për klientët jo familjarë janë pranuar ato tarifa që njësitë kanë aktualisht.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA, pas miratimit të tarifave të vendosura nga ERRU, për vitin 2025 të ardhurat e pritshme mbulojnë 108.6% të kostove operacionale të pritshme të aktivitetit UK, për vitin 2026 do të mbulojë 113.2% të kostove O&M. Ndërsa për vitin 2027 me tarifat e propozuara nga ERRU të ardhurat e pritshme do të mbulojnë 118.6% të kostove operacionale të pritshme të aktivitetit UK.
10. ERRU, bazuar në projekt-vendimin e miratimit të tarifave, ka vendosur detyra për t'u realizuar nga ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA, si në vijim:
 - a) T'i kushtojë vëmendjen e duhur për përmbylljen sa më parë të instalimit të matësve në prodhim dhe atyre familjarë, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;
 - b) Të kryejë vlerësimin e “ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet me dhe pa ujëmatës;
 - c) Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;
 - d) Të trajtojnë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi ujin pa të ardhura, si dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2024 e në vazhdim;
 - e) Të aplikojë për nivel të ri tarifar jo më vonë se muaji qershor 2027, duke qenë se periodha rregullatore do të jetë 2025-2027;
 - f) Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioritetëve të përcaktuara në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çënimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet;

- g) Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara të paktën për vitin 2026, si dhe një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e rradhës.
 - h) Të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e armotizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes që ka bërë në modelin e aplikimit, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar gjatë periudhës rregullatore.
 - i) Me mbështetjen e Task-Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa on-line dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.
 - j) Treguesi i eficensës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse, duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit me përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.
 - k) Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të ketyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.
11. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.
12. Në bazë të neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.

13. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU:
- a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjiellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
 - e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
14. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjiellës Kanalizimeve.
15. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat SHA.

16. ERRU e ka parë të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifatat variabël të shërbimit FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale UK Berat SHA, por jo në nivelet e propozuara nga kjo ndërmarrje, duke e bazuar analizën në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.
17. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021, përmban dhe aprovimin e prezantimit për në seancën dëgjimore me publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare web të ERRU, konstatohet se janë bërë publike zhvillimi i këtyre seancave dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë.
18. ERRU në analizën ekonomiko - financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot e shërbimit të ofruar, me qëllim që kostot në drejtim të rritjes së performancës, të administrimit dhe të rishpërndarjes së burimit të të ardhurave për uljen e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, të jenë rezultat i menaxhimit efektiv, i rritjes së nivelit të faturimit si edhe i mundësive të investimit, nga ku konstatohet se treguesit janë pozitiv.
19. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe (f), nenin 26, nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) si vijon:
 - i. Tarifatat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.

- ii. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1191, Datë 26. 06. 2025

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA:

VËREN SE:

1. Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) nëpërmjet shkresës nr. 565 prot., datë 13.06.2025, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 317 prot., datë 04.06.2025, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për nivel të ri të tarifave të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA, e cila ka paraqitur kërkesë për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, në të gjithë zonën e shërbimit të saj, më datë 28.06.2024, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga vlerësimi i projekt-vendimit “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA” dhe relacionit përkatës, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), për të gjitha njësitë, të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja Rajonale UK Elbasan SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese sipas:
 - Vendimit të KKRR nr. 33, datë 11.05.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë ujësjellës kanalizime Gramsh SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 75, datë 19.10.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Librazhd Përrenjas SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 576, datë 02.12.2022 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur për shoqërinë ujësjellës kanalizime Elbasan SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 119, datë 20.10.2020 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur për shoqërinë ujësjellës kanalizime Peqin SHA.
5. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifar, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrijë në fund të vitit 2027, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballojë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.
6. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes, dhe si rrjedhojë objektivi i saj është fillimisht mbulimi i kostove të tyre. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese, e riorganizuar në një njësi rajonale.
7. Në vijim të kërkesës së ndërmarrjes rajonale UK Elbasan SHA, ERRU e ka vlerësuar të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifar për tarifatat variabël të shërbimit FU dhe KUN për këtë

ndërmarrje, por jo në nivelet e propozuara prej saj. Është pranuar një rritje jo shumë e madhe, por e konsideruar rationale të niveleve të tarifave për zonat rurale me qëllim unifikimin tarifor në mënyrë që shoqëria të mundësojë ofrimin e cilësisë më të mirë të mundshme me një çmim të arsyeshëm dhe të rrisë qëndrueshmërinë e saj financiare, duke marrë në konsideratë përmbushjen e kriterit të përballueshmërisë së faturës mujore.

8. Në variantin e propozuar, është pranuar si i arsyeshëm propozimi i shoqërisë për KUN për klientët familjarë dhe jo familjarë me qëllim unifikimin e kësaj tarife për të gjithë zonën. Gjithashtu, tarifa volumetrike për shërbimin FU për klientët familjarë është vendosur e unifikuar për gjithë zonën e shërbimit nga ndërmarrja rajonale UK Elbasan SHA, ndërsa për klientët jo familjarë janë pranuar ato tarifa që njësitë kanë aktualisht.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA, pas miratimit të tarifave të vendosura nga ERRU, për vitin 2025 të ardhurat e pritshme mbulojnë 78.2% të kostove operacionale të pritshme të aktivitetit UK, për vitin 2026 do të mbulojë 88% të kostove O&M. Ndërsa për vitin 2027 me tarifën e propozuar nga ERRU të ardhurat e pritshme do të mbulojnë 83.6% të kostove operacionale të pritshme të aktivitetit UK.
10. ERRU, bazuar në projekt-vendimin e miratimit të tarifave, ka vendosur detyra për t'u realizuar nga ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA, si në vijim:
 - l) T'i kushtojë vëmendjen e duhur për përmbylljen sa më parë të instalimit të matësve në prodhim dhe atyre familjarë, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;
 - m) Të kryejë vlerësimin e "ujit të prodhuar" bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet me dhe pa ujëmatës;
 - n) Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;
 - o) Të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi ujin pa të ardhura, si dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2024 e në vazhdim;
 - p) Të aplikojë për nivel të ri tarifor jo më vonë se muaji qershor 2027, duke qenë se periodha rregullatore do të jetë 2025-2027;
 - q) Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioritetëve të përcaktuara në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së

- dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet;
- r) Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara të paktën për vitin 2026, si dhe një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e rradhës.
 - s) Të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e armotizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes që ka bërë në modelin e aplikimit, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar gjatë periudhës rregullatore.
 - t) Me mbështetjen e Task-Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa on-line dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.
 - u) Treguesi i eficensës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse, duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit me përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.
 - v) Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të ketyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.
11. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.
12. Në bazë të neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti

i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.

13. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU:
 - f. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - g. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjetllës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - h. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - i. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
 - j. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
14. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjetllës Kanalizimeve.
15. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrja rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar

ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA.

16. ERRU e ka vlerësuar të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifat variabël të shërbimit FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale UK Elbasan SHA, por jo në nivelet e propozuara nga kjo ndërmarrje, duke e bazuar analizën në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.
17. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021, përmban dhe aprovimin e prezantimit për në seancën dëgjimore me publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare web të ERRU, konstatohet se janë bërë publike zhvillimi i këtyre seancave dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë.
18. ERRU në analizën ekonomiko - financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot e shërbimit të ofruar, me qëllim që kostot në drejtim të rritjes së performancës, të administrimit dhe të rishpërndarjes së burimit të të ardhurave për uljen e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, të jenë rezultat i menaxhimit efektiv, i rritjes së nivelit të faturimit si edhe i mundësive të investimit, nga ku konstatohet se treguesit janë pozitiv.
19. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe (f), nenin 26, nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) si vijon:

- iii. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- iv. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1192, Datë 26. 06. 2025

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA:

VËREN SE:

1. Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) nëpërmjet shkresës nr. 566 prot., datë 13.06.2025, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 323/1 prot., datë 10.06.2025, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për nivel të ri të tarifave të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA, e cila ka paraqitur kërkesë për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, në të gjithë zonën e shërbimit të saj, më datë 27.06.2024, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga vlerësimi i projekt-vendimit “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA” dhe relacionit përkatës, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), për të gjitha njësitë, të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja Rajonale UK Korçë SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese sipas:
 - Vendimit nr. 39, datë 26.06.2024 i Këshillit Bashkiak Devoll “Për dhënie mendimi për ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”.
 - Vendimit nr. 46, datë 31.07.2024 i Këshillit Bashkiak Pustec “Për dhënien e mendimit nga ana e Këshillit Bashkiak Pustec lidhur me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimit e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”.
 - Vendimi nr. 71, datë 19.07.2024 i Këshillit Bashkiak Kolonjë “Për shprehjen e mendimit në lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë rajonale UK Korçë”.
 - Vendimi nr. 71, datë 28.06.2024 i Këshillit Bashkiak Maliq “Për dhënien e mendimit për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë rajonale”.
5. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifar, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrijë në fund të vitit 2029, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballojë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.
6. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes, dhe si rrjedhojë objektivi i saj është fillimisht mbulimi i kostove të tyre. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese, e riorganizuar në një njësi rajonale.

7. Në vijim të kërkesës së ndërmarrjes rajonale UK Korçë SHA, ERRU e ka vlerësuar të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifatat variabël të shërbimit FU dhe KUN për këtë ndërmarrje, por jo në nivelet e propozuara prej saj. Është pranuar një rritje jo shumë e madhe, por e konsideruar racionale të niveleve të tarifave për të gjithë zonën e shërbimit me qëllim unifikimin tarifor, duke patur parasysh edhe planin e investimeve të shoqërisë në njësitë përkatëse. Qëllimi mbetet që shoqëria të mundësojë ofrimin e cilësisë më të mirë të mundshme me një çmim të arsyeshëm dhe të rrisë qëndrueshmërinë e saj financiare, duke marrë në konsideratë përmbushjen e kriterit të përballueshmërisë së faturës mujore.
8. Në variantin e propozuar nga KKRR, tarifatat fikse janë unifikuar për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit sipas propozimit të shoqërisë, si një shërbim që i ofrohet konsumatorëve në mënyrë të barabartë dhe në çdo moment pavarësisht zonës së shërbimit dhe largësisë. Bazuar në metodën e “çmimit tavan”, tarifatat fikse janë të pandryshuara për gjithë periudhën rregullatore, pa ndryshim ndërmjet kategorisë së klientëve familjarë apo jo-familjarë.
9. Është pranuar si i arsyeshëm propozimi i shoqërisë për tarifatat volumetrike të shërbimit të kanalizimeve për të gjitha kategoritë e klientëve si për Zonën A-Njësia Korçë e cila ka edhe një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura si dhe për Zonën B-njësitë e tjera përbërëse të ndërmarrjes rajonale UK Korçë SHA. Kjo pasi gjatë periudhës rregullatore janë parashikuar një sërë investimesh në drejtim të KUN dhe ITUN si në njësinë e Maliqit dhe Pustecit.
10. Gjithashtu, referuar metodologjisë së përcaktuar nga KKRR, është pranuar propozimi i shoqërisë për tarifatat volumetrike për shërbimin FU për klientët familjarë me qëllim unifikimin, ndërsa për klientët jo familjarë janë propozuar tarifatat ekzistuese të njësitëve sepse nuk respektohet koeficienti i ndërfinancimit ndërmjet kategorive të klientëve.
11. Vlen të theksohet se tarifatat e zonës përbërëse të ndërmarrjes rajonale UK Korçë SHA nuk janë ndryshuar prej shumë vitesh, konkretisht prej 8 vitesh për njësitë Korçë dhe Maliq, prej 10 vitesh për njësinë Kolonjë dhe prej 13 vitesh për njësinë Devoll. Ndërkohë që njësia Pustec, edhe pse me tarifa të pamiratuara nga ERRU, ka rreth 9 vite që aplikon këtë nivel tarifor që nga krijimi i saj si shoqëri sipas VKM Nr. 63 të vitit 2016. Nga ana tjetër, niveli i kostove, gjatë këtyre viteve, ka ardhur duke u rritur, nisur nga kostot e energjisë elektrike apo rritja e pagave.
12. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, pas miratimit të tarifave të vendosura nga ERRU, për vitin 2025 të ardhurat e pritshme mbulojnë 133.6% të kostove operacionale të pritshme të aktivitetit UK, për vitin 2026 do të mbulojnë 129.28% të tyre, për vitin 2027 do të mbulojnë 127.6%, për vitin 2028 do të mbulojnë 124.5% dhe për vitin 2029 do të mbulojnë 122.8%.

13. ERRU, bazuar në projekt-vendimin e miratimit të tarifave, ka vendosur detyra për t'u realizuar nga ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA, si në vijim:

- a) T'i kushtojë vëmendjen e duhur për përmbylljen sa më parë të instalimit të matësve në prodhim dhe atyre familjarë, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;
- b) Të kryejë vlerësimin e “ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet me dhe pa ujëmatës;
- c) Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;
- d) Për aplikimin tarifor të rradhës që duhet të jetë jo më vonë se qershor 2029, duke qenë se shoqëria do të arrijë të mbulojë në fund të periudhës rregullatore 100% të kostove totale, pritët të aplikojë sipas metodës “çmim tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyruesisht i shoqëruar me planin e biznesit 5 vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU.
- e) Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në mënyrë që të evitohen vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet;
- f) Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara të paktën për vitin 2028, si dhe një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e rradhës.
- g) Me mbështetjen e Task-Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa on-line dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.
- h) Treguesi i efikasitetit të stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse, duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit me përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.
- i) Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.

14. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.
15. Në bazë të neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.
16. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësijellës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU:
- k. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - l. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësijellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - m. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - n. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të

- operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
- o. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
17. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjellës Kanalizimeve.
18. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrja rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA.
19. ERRU e ka vlerësuar të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifar për tarifatat variabël të shërbimit FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale UK Korçë SHA, por jo në nivelet e propozuara nga kjo ndërmarrje, duke e bazuar analizën në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.
20. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021, përmban dhe aprovimin e prezantimit për në seancën dëgjimore me publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare web të ERRU, konstatohet se janë bërë publike zhvillimi i këtyre seancave dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë.
21. ERRU në analizën ekonomiko - financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot e shërbimit të ofruar, me qëllim që kostot në drejtim të rritjes së performancës, të administrimit dhe të rishpërndarjes së burimit të të ardhurave për uljen e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, të jenë rezultat i menaxhimit efektiv, i rritjes së nivelit të faturimit si edhe i mundësive të investimit, nga ku konstatohet se treguesit janë pozitiv.

22. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe (f), nenin 26, nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) si vijon:

- v. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujës-jellës Kanalizime Korçë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
- vi. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1193, Datë 26. 06. 2025

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE BANKËS SË SHQIPËRISË PËR
TREGUN E SHËRBIMEVE BANKARE NË BANKOMATE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 06. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e disa rekomandimeve Bankës së Shqipërisë për tregun e shërbimeve bankare në bankomate.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të shërbimeve bankare në bankomatet e Bashkisë Sarandë”:

VËREN SE:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në rezolutën e tij “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023” të miratuar në datën 25.07.2024, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës “të vijojë të përforcojë zbatimin e rregullave të konkurrencës, me qëllim që të ndihmojë në sigurimin e një tregu më të drejtë dhe konkurrues në Shqipëri, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe duke nxitur një mjedis të shëndetshëm të biznesit, me qëllim sigurimin e një konkurrence efektive në tregun e shërbimeve bankare digjitale nëpërmjet monitorimit të tarifave dhe komisioneve të shërbimeve bankare”.
2. Në përmbushje të detyrimit të vendosur në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar me monitorimin e komisioneve të vendosura mbi tërheqjen e parave në bankomatet e bankave të cilat operojnë në Bashkinë Sarandë.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme gjatë monitorimit, u kërkuar të dhëna dhe informacion bankave që operojnë në Republikën e Shqipërisë sipas listës së publikuar në

faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, për subjektet e licencuara “banka”, në të cilën numërohen 11 institucione financiare, si në vijim: Banka Amerikane e Investimeve SHA, Banka Credins SHA, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka e Parë e Investimeve Albania SHA, Banka Intesa Sanpaolo Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Banka OTP Albania SHA, Banka Procredit SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka Tirana SHA dhe Banka Union SHA.

4. Banka e Shqipërisë, me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 59, datë 29.08.2008 “Për miratimin e Rregullores “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare”, në nenin 5 ka parashikuar se: “Bankat informojnë paraprakisht klientin, në rastin e përdorimit të kartave të debitit/cash dhe të kartave të kreditit, për kushtet e përdorimit dhe për komisionet e veprimeve që kryhen me kartë, në veçanti në ATM-të e bankës dhe ATM-të e bankave të tjera. Ky informacion afishohet për klientin pranë ATM-së, përveçse informimit në marrëveshjen (kontratën) e lidhur për këtë lloj shërbimi. Përmbajtja e njoftimit që do të vendoset pranë çdo ATM-je të bankës do të jetë sipas aneksit 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.” Gjithashtu, sipas këtij neni, bankat hartojnë dhe miratojnë sipas mënyrave të parashikuara në rregulloret e tyre të brendshme metodën/politikën e llogaritjes të komisioneve për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare.
5. Përveç Bankës Procredit dhe Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA), të gjitha bankat e regjistruara në Republikën e Shqipërisë ofrojnë shërbim nëpërmjet bankomateve të tyre në Bashkinë e Sarandës. Katër (4) prej këtyre bankave, konkretisht: Banka e Parë e Investimeve Albania (Fibank), Banka OTP Albania, Banka Union dhe Banka Amerikane e Investimeve (ABI), janë palë e nënkontraktuar nga kompani të tjera, për shërbimin e furnizimit me para fizike dhe përdorimin e rrjetit të tyre të bankomateve. Numri i bankomateve të nënkontraktuar është i ndryshueshëm përgjatë muajve të periudhës raportuese.
6. Nga informacioni i administruar u vlerësuan pjesët e tregut për secilën bankë, duke mbajtur në konsideratë se muajt përgjatë të cilëve shfaqet numri më i lartë i bankomateve të nënkontraktuar përgjatë periudhës raportuese janë korriku dhe gushti, në bazë të (i) numrit të bankomatëve, (ii) numrin të transaksioneve, (iii) vlerës mesatare të tërheqjeve dhe (iv) vlerës totale të tërheqjeve. Në bankomatet në Bashkinë Sarandë rezulton se, në kuptim të nenit 8 të Ligjit nr. 9121/2003, asnjë nga bankat nuk ka pozitë dominuese në këtë treg.
7. Klientët kanë mundësi të zgjedhin lirisht në cilin bankomat të kryejnë tërheqjet e tyre, duke mos u kufizuar nga banka në të cilën kanë llogarinë bankare. Asnjë bankë nuk aplikon komision për tërheqjet në rrjetin e tyre të bankomateve për kartat vendase. Por të gjitha bankat aplikojnë komisione për klientët kartëmbajtës të tyre, në rastet kur tërheqin në bankomatet e

bankave të tjera, për arsye se transaksioni shoqërohet me kosto shtesë. Ato variojnë për tërheqjet nga kartat VISA apo Mastercard, debiti apo krediti.

8. Në rastin kur klientët janë pajisur me kartën e një vendi jashtë territorit të Shqipërisë dhe kërkojnë të tërheqin në monedhën LEK në bankomatin e bankës: aplikohet një komision fiks (surcharge), pavarësisht vlerës së tërheqjes së fondeve për çdo transaksion nga kartat e huaja, ose iu ofrohet shërbimi i Këmbimit Dinamik të Valutës (DCC), aplikimi i të cilit është opsional, duke i lejuar klientëve të pajisur me karta të huaja të kryejnë tërheqjen e parave në monedhën origjinale të kartës me një kurs këmbimi të aplikuar nga banka. Për këtë shërbim, klientit i mbahet një përqindje shtesë (mark-up) nga banka në bankomatin e të cilës kryhet transaksioni, e cila i shtohet komisionit (surcharge) të aplikuar.
9. Tarifat dhe komisionet e aplikuara nga bankat për tërheqjet me karta ndërkombëtare, si dhe për tërheqjet e klientëve të tyre në bankomatet e bankave të tjera ndryshojnë midis bankave, por diferencat nuk janë domethënëse. Bankat që përdorin rrjete të nënkontraktuara zakonisht aplikojnë tarifa më të larta për këtë shërbim.
10. E njëjta gjë vlen dhe për aplikimin e mark-up, si një përqindje shtesë për ofrimin e Shërbimit të Këmbimit Dinamik të Valutës (DCC), i cili është i ndryshëm midis bankave, si dhe sipas llojit të rrjetit të bankomateve të përdorur prej tyre (në pronësi të bankës apo të nënkontraktuar), si dhe sipas llojit të rrjetit të bankomateve të përdorur prej tyre (në pronësi të bankës apo të nënkontraktuar), duke reflektuar kosto dhe politika të ndryshme operationale.
11. Për sa më sipër, nuk ngrihen dyshime të arsyeshme se në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare në bankomatet në Bashkinë Sarandë ka problematika apo elementë të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në kuptim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
12. Megjithatë, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se tregu karakterizohet nga një nivel i kufizuar i transparencës dhe harmonizimit të tarifave, sidomos për komisionet e aplikuara ndaj kartëmbajtësve të huaj dhe përdorimin e rrjeteve të bankomateve të nënkontraktuara.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. T'i rekomandojë Bankës së Shqipërisë, si institucioni mbikëqyrës i veprimtarisë bankare të bankave të licencuara në Republikën e Shqipërisë, që me qëllim sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe transparente në tregun e shërbimeve bankare në bankomate, të marrë masat e mëposhtme:
- i. Të kontrollojë metodologjinë për llogaritjen e komisioneve për tërheqjet në bankomate, si dhe për kartëmbajtësit vendas ashtu edhe për ata të huaj, duke përfshirë edhe 'mark-up' për shërbimin e Këmbimit Dinamik të Valutës (DCC), nëse praktikatat e ndjekura nga bankat janë në përputhje me aktet rregullative në fuqi.
 - ii. Të kërkojë nga bankat raportim periodik dhe publikim të komisioneve në një format të unifikuar, të aksesueshëm për publikun në faqet e tyre zyrtare dhe në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
 - iii. Bazuar në rezultatet e kontrolleve sipas pikës "I/i" të këtij vendimi, të shqyrtojë nevojën për ndërhyrje rregullatore që lidhen me përdorimin e rrjeve të nënkontraktuara të bankomateve, me qëllim parandalimin e aplikimit të komisioneve disproporcionale.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

2025

BULETINI ZYRTAR



2025